

PLANI LOKAL PËR VEPRIM NË MJEDIS (PLVM) PËR KOMUNËN DIBËR

Dibër, 01.07.2009



РЕГИОНАЛЕН ЦЕНТАР
ЗА ЖИВОТНА СРЕДИНА



VENDIM
Nr. 07-874/3 dt. 30.09.2009
PËR SJELLJEN E PLVM
(Planit Lokal për Veprim në Mjedis) PËR KOMUNËN DIBËR

Në mbështetje të nenit 60 paragrafi 2 të Ligjit për ambientin jetësor ("Gazeta zyrtare e RM" nr 53/05,81/05 dhe 24/07), nenit 36 të Ligjit për vetqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RM" nr.5/2002) dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër ("Kumtesa zyrtare e komunës Dibër" nr. 14/03),
Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 4^{të} dt. 30.09.2009 vendosi:

Neni 1

Këshilli i Komunës Dibër sjell **PLVM -Planin Lokal për Veprim në Mjedis PËR KOMUNËN DIBËR**, propozuar nga Komiteti lokal për përgatitjen e PLVM .

Neni 2

Plani Lokal për Veprim në Mjedis- PLVM për Komunën Dibër, është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e sjelljes dhe do të shpallet në "Kumtesën zyrtare të Komunës".

KËSHILLI I KOMUNËS

Kryetari,
Nizamedin Papraniku



TË NDERUAR LEXUES,



K rryetari i Komunës -Argëtim Fida

Ndjej shumë kënaqësi, që kam nderin T'ua prezentoj Planin e dytë Lokal për Veprim në Mjedisin Jetësor (PLVM) për Komunën e Dibrës.

Bëhet fjalë për një dokument me rëndësi të jashtëzakonshme, i cili në gjashtë vitet e ardhëshme komunës do t'ja jep drejtimit kryesore për të vepruar në fushën e mbrojtjes të mjedisit jetësor. Në të njëjtën kohë, me këtë përmbushet edhe zbatimi i njëres nga kompetencat dhe obligimet që u janë dhënë vetëqeverisjeve lokale me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe me Ligjin për mjedisin jetësor.

PLVM i parë për Dibrën është miratuar nga Këshilli Komunal më datë 29.02. të vitit 2000. Gjatë kësaj periudhe prej 9 viteve janë ndryshuar gjendjet në aspektin e kompetencave ligjore të Komunës, të zgjidhjeve të reja ligjore në lëmin e mjedisit jetësor dhe është caktuar metodologjia e re për hartimin e PLVM, si edhe nga fakti se një pjesë e aktiviteteve të parashikuara janë analizuar.

Mbi bazën e nenit 60 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta Zyrtare e RM nr.53/2005) PNVM dhe PLVM (NEAP DHE LEAP) janë për një periudhë kohore prej 6 vitesh dhe të njëjtët duhet të përsëriten pas kalimit të këtij afati, për këtë arsye ishte e domosdoshme nevoja e përgatitjes dhe nxjerrjes së PLVM (LEAP) të rij, i cili do të përgatitet në bazë të metodologjisë së re të caktuar i harmonizuar me gjendjet e reja në ambientin jetësor.

PLVM (LEAP) i Komunës së Dibrës është punuar në përputhje me metodologjinë DPSIR e cila oficialisht është miratuar nga Ministria për ambientin jetësor dhe rregullin hapësinor. Modeli DPSIR thekson lidhjen e shkakut-pasojës dhe u ndihmon atyre që marri vendime që ti shqyrtojnë bashkarisht çështjet ekonomike, sociale dhe çështjet nga lëmi i mjedisit jetësor.

Me fjalë të tjera, bëhet fjalë për një mjet me të cilin bëhen i mundshëm implementimi i parimeve e zhvillimit të qëndrueshëm të bashkësisë.

Në hartimin e PLVM (LEAP), punohej në vazhdimësi gjatë periudhës prej një viti. Gjatë procesit nëpërmjet punës në Komitetin Lokal dhe në grupet e punës, u inkuadruan edhe një numër i madh i institucioneve dhe individëve, i përfaqësuesve të organizatave qytetare dhe i bashkësive lokale. Pa angazhimin e tyre të pamohueshëm, do të ishte e pamundur që do të arrimë deri te rezultati i sotëm dhe për këtë arsye u shpreh falenderimin tim të madh.

Gjithashtu, për ne si vetëqeverisje lokale, rëndësi të madhe kishte mbështetja që na e dha popullata lokale, e cila në mënyrë aktive merr pjesë në hartimin e këtij dokumenti nëpërmjet pjesëmarrjes në takimet publike dhe të përfshirjes në anketën.

E tërë kjo do të ishte e pamundur nëse nuk do ta kishim përkrahjen e ekspertëve nga Qendra Rajonale për Mjedisin Jetësor për Evropën Qëndrore dhe Lindore-Zyra e QRMJ (REC) në Maqedoni dhe mjetet financiare të siguruara nga Qeveria e Suedisë, nëpërmjet Agjencionit ndërkombëtar të Suedisë për bashkëpunim dhe zhvillim –SIDA, për çka i falemnderojmë përzemërsisht.

Me respekt,
Kryetari i Komunës
Argëtim Fida

HYRJE

Plani Lokal për Veprim në Mjedis- PLVM (LEAP) është dokument i cili në mënyrë efektive duhet tu ndihmojë bashkësive që t'i identifikojnë problemet në mjedisin jetësor me aplikimin e qasjes në përfshirjen më të gjërë të publikut. Edhe përkundër faktit që edhe publiku edhe institucionet janë të vetdijshëm për problemet me të cilat për çdo ditë ballafaqohen, është shumë vështirë qasja në mënyrë aktive dhe efektive e zgjidhjes së problemeve të ambientit jetësor. Procesi i hartimit të PLVM (LEAP) ndihmon në krijimin e atmosferës për zgjidhjen aktive dhe efektive të problemeve. Kjo është një nga arsyet, që Komuna e Dibrës ti qaset hartimit të planit për zgjidhjen e problemeve të ambientit jetësor, të quajtur Plani Lokal për Veprim në Mjedis - PLVM.

Qëllimi kryesor për përgatitjen e PLVM për Komunën e Dibrës është që të krijohet plani (strategjia) e aktiviteteve për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor, bazuar në konsensusin ndërmjet Pushtetit Lokal-Komunës, qytetarëve dhe organizatave joqeveritare. Plani duhet të mbështetet në zgjidhje reale dhe të pranueshme e të justifikueshme nga aspekti ekonomik për tejkalimin e problemeve të evidentuar në mjedisin jetësor. Realizimi i funksionit të këtyre të PLVM (LEAP) nënkupton analizën e gjendjeve dhe të caktimit të nevojave për zgjidhjen e problemeve të mjedisit jetësor.

Për tu hartuar PLVM duhet të kalojë nëpër procesin e planifikimit, i cili përbëhet nga këto faza:

1. Formimi i strukturës organizative për hartimin e PLVM, e cila përbëhet nga bashkërenduesi lokal, komiteti lokal dhe grupet e punës.
2. Hartimi i planit për përfshirje të publikut;
3. Vlerësimi i gjendjeve në ambientin jetësor;
4. Përcaktimi i problemeve me përparësi të mjedisit jetësor që duhet zgjidhur;
5. Caktimi i qëllimeve dhe i masave;
6. Përcaktimi i mekanizmave për zbatimin e PLVM;
7. Përcaktimi i mekanizmave operative për ndjekjen dhe vlerësimin e zbatimit;
8. Revizioni i PLVM

Në procesin e analizës së gjendjeve dhe të përcaktimit të problemeve u përfshinë komponentët kryesor të mjedisit jetësor: grumbullimi, seleksionimi dhe vendosja në deponi e mbeturinave, mospajisja me rrjetin për furnizimin me ujë, heqja e ujërave të zeza, cilësia e ajrit dhe infrastruktura energjetike.

Plani lokal aksional i aktiviteteve për mbrojtjen dhe përparimin e ambientit jetësor në Komunën e Dibrës është bazë për ndërtimin e politikës përkatëse për mbrojtjen e mjedisit jetësor, për funksionimin e vërtetë të demokracisë lokale, për krijimin e ekonomisë që do të jetë më gjithëpërfshirëse dhe e cila do të përcaktojë dhe përfshijë vlerat e ujërave, të ajrit, të truallit dhe të biodiversitetit, si edhe për shfrytëzimin e resurseve.

PLVM është dokument kompleks, i cili krijon planin dinamik të aktiviteteve për mbrojtjen dhe përparimin e cilësisë së mjedisit jetësor, veçanërisht nëpërmjet aspekteve ekonomike dhe treguesve zhvillimor, politikës buxhetore dhe investimeve publike, gjë që do të sigurojë qasjen në zgjidhjen e problemeve lidhur me mjedisin jetësor dhe zhvillimin.

Baza e këtij koncepti për hartimin e Planit Lokal Aksional për Mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor mbështetet në krijimin e parkushteve institucionale dhe të parakushteve tjera

për veprim aktiv në nivel lokal por edhe më gjërë. Kjo kërkon integrimin e politikës për ambientin jetësor në të gjitha politikat në të gjitha politikat dikasteriale (zhvillimore) në nivel lokal dhe shtetëror.

PLVM duhet të shfrytëzohet edhe si mundësi për promovimin dhe vendosjen e themeleve organizative dhe ekonomike të cilët do të jenë bazë për zbatimin e parimeve për zhvillim të qëndrueshëm në Komunë. Realizimi i aktiviteteve të propozuara është proces afatgjat, i cili duhet të realizohet nëpërmjet hapave të vegjël, në mënyrë racionale dhe të durueshme. Efekti do të jetë pozitiv nëse realizohet qasja reale drejt zgjidhjes së çdo problemi konkret.

REZYMEJA ZBATUESE (PËRMBLEDHËSE)

Edhe përkundër faktit se publiku dhe institucionet janë të vetëdijshme për problemet me të cilat ballafaqohen çdo ditë, qasja aktive dhe efektive për zgjidhjen e problemeve të ambientit jetësor është shumë e vështirë. Procesi i hartimit të PLVM (LEAP) ndihmon që të krijohet atmosfera e zgjidhjes aktive dhe efektive e problemeve. Kjo është një nga arsyet që Komuna e Dibrës i është qasur hartimit të planit për zgjidhjen e problemeve të ambientit jetësor, që quhet Plani Lokal për Veprim në Mjedis - PLVM.

Mjetet që ka në dispozicion komuna për rregullimin e cilësdoqoftë problematikë janë të kufizuara e njëjtja gjë vlen edhe për lëmin e mjedisit jetësor. Për këtë arsye zgjidhja e problemeve të ambientit jetësor në Komunën e Dibrës mund të arihet vetëm me aplikimin e strategjive me më pak buxhet dhe efektive për ballafaqimin me problemet lidhur me ambientin jetësor. Me këtë rast, për të patur përkrahjen e qytetarëve, që është parakusht themelor për ndryshimin e gjendjes së ambientit jetësor në Komunë, nevojitet edhe përfshirja e qytetarëve qysh në procesin e planifikimit dhe të definimit të strategjive, si edhe në procesin e marrjes së vendimeve përfundimtare.

Procesi i hartimit të PLVM për Komunën e Dibrës, u realizua me qëllim të realizimit të këtyre objektivave:

- Vlerësimi i gjendjes së ambientit jetësor në territorin e Komunës së Dibrës,
- Definimi dhe radhitja e problemeve të ambientit jetësor në Komunë;
- Zhvillimi i strategjive dhe aktiviteteve për ballafaqimin me problemet e ambientit jetësor në Komunë;

Rritja e vetëdijes dhe e përgjegjësisë publike për investimet në lëmin e mjedisit jetësor si dhe për rritjen e përkrahjes nga publiku për investimet në lëmin e mjedisit jetësor në Komunë. Hartimi i planit lokal aksional për ambientin jetësor u realizua nëpër këto faza:

- Formimi i strukturës organizative dhe hartimi i PLVM;
- Hartimi i planit për përfshirjen e publikut
- Vlerësimi i gjendjes së ambientit jetësor në Komunë;
- Përcaktimi i problemeve me përparësi;
- Definimi i qëllimeve dhe masave;
- Përcaktimi i mekanizmave për zbatimin e PLVM ;
- Përcaktimi i mekanizmave operative për mbykëqyrjen, vlerësimin e zbatimit dhe të revizionit të PLVM .

Si rezultat i realizimit të procesit, janë fituar këto rezultate:

- Është vendosur struktura për bashkëpunim ndërmjet më shumë faktorëve shoqëror në Komunë (përfaqësues në këshillin e Komunës, të administratës lokale të ndërmarjeve

publike,përfaqësues të sektorit të biznesit,të institucioneve shëndetësore,të organizatave joqeveritare dhe të individëve).

- Publiku është informuar për problemet ekzistuese të ambientit jetësor në Komunë;
- Është rritur vetëdija publike për çështjet lidhur me ambientin jetësor;
- Janë zhvilluar strategjitë për zgjidhjen e problemeve të ambientit jetësor;
- Janë krijuar kushtet për investimet e jashtme në lëmin e mjedisit jetësor.

Partenrët në procesin e hartimit të PLVM në Komunën e Dibrës ishin:

- SIDA-agjensioni ndërkombëtar i Suedisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim
- REC-Qendra Rajonale për Mbrojtjen e Ambientit Jetësor për Evropën Qëndrore dhe Lindore zyra në Maqedoni;
- Shoqata Ekologjike “Deshat”-Dibër
- Qendra për zhvillim të qëndrueshëm- Dibër
- NKP “Standard”

Në procesin e **hartimit të** PLVM ishin përfshirë edhe qytetarët, individët dhe përfaqësuesit e pushtetit lokal, bashkësitë lokale, sektori i biznesit dhe organizatat joqeveritare nga Komuna. I tërë procesi i hartimit të planit ishte realizuar gjatë periudhës prej afër 1 viti,dhe si rezultat i kësaj, janë fituar këto produkte:

-Vlerësimi I gjendjes së ambientit jetësor në Komunën e Dibrës edhe atë në këto lëmenj tematikë:

- AJËRI
- UJËRAT
- MBETURINAU
- NATYRA
- TOKA DHE SHFRYTËZIMI I TRUALLIT.

-Është definuar lista e problemve me përparësi nga lëmi i mjedisit jetësor;

-Janë definuar qëllimet dhe masat për ballafaqimin me secilin nga problemet me përparësi;

-Është zhvilluar plani për zbatimin , si edhe plani për mbykëqyrjen , vlerësimin e zbatimit dhe të revizionit të PLVM.

Procesi i hartimit të PLVM (LEAP)

Plani lokal aksional i ambientit jetësor është dokument i cili është fituar nëpërmjet procesit që promovon zhvillim të qëndrueshëm. Mjetet që janë në dispozicion të Komunës për rregullimin e cilës do qoftë problematikë janë të kufizuara. Për këtë arsye zgjidhja e problemeve të ambientit jetësor në Komunën e Dibrës mund të arrihet vetëm me aplikimin e strategjive të buxhetit të vogël dhe efektiv për ballafaqimin me probleme lidhur me mjedisin jetësor. Me këtë rast, për të patur përkrahjen e qytetarëve, që është parakusht themelor për ndryshimin e gjendjes së ambientit jetësor në Komunë, nevojitet edhe përfshirja e qytetarëve qysh në procesin e planifikimit dhe të definimit të strategjive, si edhe në procesin e marrjes së vendimeve përfundimtare


Procesi i hartimit të PLVM për Komunën, u realizua për arritjen e këtyre objektivave.

- Vlerësimi i gjendjes së ambientit jetësor në teritorin e Komunës së Dibrës;
- Definimi dhe radhitja e problemeve të ambientit jetësor në Komunë;
- Zhvillimi i strategjive dhe i aktiviteteve për ballafaqimin me problemet e ambientit jetësor në Komunë;
- Rritja e vetëdijes dhe e përgjegjësisë publike për mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe për rritjen e përkrahjes nga publiku për investimet nga lëmi I mjedisit jetësor në Komunë.
- Procesi i hartimit të PLVM (LEAP) për Komunën e Dibrës filloi në muajin maj të vitit 2008, me nënshkrimin të marrëveshjes për përkrahje për hartimin e PLVM (LEAP) ndërmjet Komunës së Dibrës dhe Qendrës Rajonale për Ambientin Jetësor-QRAJ (REC). Hartimi i Planit Lokal Aksional për Mjedisin Jetësor në Komunën e Dibrës u realizua nëpër këto faza:
- Formimi i strukturës organizative për hartimin e PLVM (LEAP);
- Hartimi i planit për përfshirjen e publikut;
- Vlerësimi i gjendjes së mjedisit jetësor në Komunë;
- Përcaktimi i problemve me përparësi;
- Definimi i objektivave dhe masave;
- Përcaktimi i mekanizmave për zbatimin e PLVM (LEAP);
- Përcaktimi i mekanizmave operativë për mbykëqyrje, vlerësimin e zbatimit dhe të revizionit të PLVM (LEAP).

Si rezultat i realizimit të procesit, janë fituar këto rezultate:

- Është vendosur struktura për bashkëpunimin ndërmjet më shumë faktorëve shoqëror në Komunë (përfaqësues të Këshillit të Komunës, të administratës lokale, të ndërmarjeve publike, përfaqësues të sektorit të biznesit, të institucioneve shëndetësore, të organizatave joqeveritare dhe të individëve;
- Publiku është informuar për problemet ekzistuese të mjedisit jetësor në Komunë;
- Është rritur vetëdija publike për çështjet lidhur me ambientin jetësor;
- Janë zhvilluar strategjitë për zgjidhjen e problemeve të ambientit jetësor;
- Janë krijuar kushtet për investimet e jashtme në lëmin e mjedisit jetësor.

Struktura organizative e PLVM (LEAP) në Komunën e Dibrës



Anëtarët e Komitetit Lokal për hartimin e PLVM (LEAP) për Komunën e Dibrës

1. Nizamedin Papraniku, Këshilli I Komunës-Dibër
2. Areta Pekmezi, Këshilli I Komunës Dibër
3. Mirela Korumi, Këshilli I Komunës Dibrë
4. Azir Oruçoski, Këshilli I Komunës-Dibër
5. Arbëresha Klenja-NKP "Standard"
6. Fatmir Alili, NKP "Standard"
7. Abdul Koleci, Profesor në Universitetin Shtetëror të Tetovës
8. Goce Lubinovski, OJQ "Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të bashkësisë;
9. Atli Dema OJQ Shoqata Ekologjike "Deshat"
10. Sonja Topallovska, OJQ "Qendra e Gruas"
11. Ilmi Kurtishi OJQ "Hëna"
12. Osman Mashkulli, Këshilli I Bashkësive Lokale
13. Abdulla Fidoski, BL Zepishtë-Otishan
14. Vesel Duka, NJOR e Ministrisë për bujqësi, pyll. dhe ekonomi ujore
15. Mentor Mela Enti për Mbrojtje Shëndetësore
16. Qenan Mimidinovski, Mediumet
17. Dejan Vapski, SHA "Knauf Radika"
18. Petrit Paçuku NJVL-Komuna e Dibrës
19. Shaban Jani NP "Ekonomia pyjore"-Stogovë

ANËTARËT E GRUPEVE TË PUNËS

GRUPI PUNUES AJËRI			
1	Abdul Koleci	Profesor	Universiteti I Tetovës
2	Reshat Qormemeti	Inxh. teknonlog	Administrata Komunale
3	Dejan Vapski	Inxh. I komunikacionit	SH.A."Knauf-Radika"
4	Luljeta Shehu	Spec.epidemiolog	Enti për mbrojtje shëndetësore
GRUPI PUNUES UJI			
1	Fatmir Alili	Inxh. I makinerisë	NKP "Standard"
2	Arbëresha Klenja	Inxh. e dipl. e ndërtimtarisë	NKP"Standard"
3	Ylber Daci	Doktor-Specialist I higjienës	Drejtoria e ushqimeve
4	Mentor Mela	Spec.epidemiolog	Enti për mbrojtje shëndetësore
GRUPI PUNUES "MBETURINAU"			
1	Petrit Paçuku	Inxh. I Dipl. I ndërtimtarisë	Administrata Komunale
2	Rexhep Mashkulli	Inspektor Komunal	Administrata Komunale
3	Omer Cami	Inxh.dipl.Teknolog	NKP"Standard"
4	Baki Alili	Mjek specialist	Shtëpia e shëndetit
GRUPI PUNUES „TOKA” dhe shfrytëzimi i truallit			
1	Vesel Duka	Inxh I dipl Agronom	Ministria e bujqësisë
2	Agron Pekmezi	Kryetar I kope. bujqësore	Sektor joqeveritar (OJQ)
3	Liri Delishi	Inxh. I dipl.Agronom	Ministria e bujqësisë
4	Durim Fetahu	Inxh I dipl. arkitekt	Administrat Komunale
GRUPI PUNUES NATYRA			
1	Shaban Jani	Inxh I dipl I pylltarisë	NP "Ekonomia Pyjore"
2	Fatmir Daci	Jurist	Spektori joqeveritar (OJQ)
3	Flamur Mulladauti	Arsimtar	Sh.F. "Vëllazërim Bashkim"
4	Subi Marku	Inxh I dipl I xehetarisë	SH.A."Knauf-Radika"



Takim pune i Komitetit Lokal për PLVM (LEAP) të Komunën e Dibrës

KARAKTERISTIKAT NATYRORO-GJEOGRAFIKE DHE SOCIO-EKONOMIKE TË KOMUNËS DIBËR

1. PËRSHKRIMI I KOMUNËS

Komuna e Dibrës është komunë e lashtë dhe si e tillë ka funksionuar në periudha të ndryshme. Prej vitit 2004 në përputhje me Ligjin për organizim territorial të vetëqeverisjes lokale („Gazeta zyrtare RM” br. 22/2004) është formuar Komuna e Dibrës brenda kufinjve në të cilët ajo ekziston edhe sot.

Nga regjistrimi i fundit i popullsisë në Dibrë jetojnë 19.542 banorë. Në kuadër të komunës ka 19 vendbanime, prej të cilave 5 fshatra janë shpërngulur tërësisht (Bohmova, Kojnara, Taraniku, Shushica dhe Spasi).

Vend qendror dhe seli e komunës është qyteti i Dibrës, ndërsa vendbanimet tjera janë fshatrat: Banishti, Kosovrasti i Epërm, Kosovrast i Poshtëm, Krifca, Otishani, Rajçica, Sollokiçi, TatarElevca, Ame, Mogorça, Zepishta, Osoji dhe Gajre.

1.1 Karakteristikat gjeografike

Komuna e Dibrës ndodhet në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë përbri kufirit me Republikën e Shqipërisë. Komuna është vendosur në Fushën e Dibrës ndërmjet shpatijeve të maleve Deshat (Kërçin), Liqenit të Dibrës dhe luginës së lumit Drini i Zi, i cili derdhet në liqenin e theksuar. Në të vërtetë fusha paraqet një tarracë të gjërë reliefi, e cila shkon në drejtim dhe lëshohet drejt luginës së Drinit të Zi.

Territori i Komunës së Dibrës kufizohet me territoret e komunave Mavrovë dhe Rostushë, Qendra e Zhupës, në një pjesë të vogël me Komunën Drugovë dhe Debarcë dhe me vijën kufitare shtetërore me Republikën e Shqipërisë.

Nëpër territorin e komunës kalojnë rruga kryesore Gostivar-Hanet e Mavrovës-Dibrë, rruga Dibrë-Strugë dhe rruga që çon në drejtim të vendkalimit Bllatë-Republika e Shqipërisë. Gjatësia e rrjetit rrugor kap sipërfaqen prej 145,67 km².

Qyteti i Dibrës ndodhet në lartësinë mbidetare prej 630-700 m me pozitë gjeografike 41.30.33.24 N-, 20.31.49.11 E.

Komuna e Dibrës ka pozitë tejet të volitshme gjeografike sepse në sipërfaqen e saj bashkohen dy luginat e rëndësishme dhe pitoreske kanjonike në rrjedhjen e lumenjve Radikë dhe Dirini i Zi.



1.2 Përbërja gjeologjike dhe e reliefit

Përbërja gjeologjike e terrenit të Komunës së Dibrës është shumë e larmishme dhe më një sërë manifestimesh të gjendjeve gjeologjike. Në tarracën e Dibrës bashkohen këto

formacione gjeologjike: plioceni, eoceni, pruliumi dhe flishi.

Sedimentet e ocenit janë konstatuar në perëndimin e skajshëm të luginës, në sipërfaqe të vogël rreth fshatit Kojnarë. Përfaqësohen me përbërje të glinës, rërës, konglomerateve dhe të përbërjeve laporovite të glinës.

Plioceni është zhvilluar në luginën e Dibrës ndërmjet fshatrave Banisht, Ame dhe Bohmovë, ndërsa përbëhet nga rërat dhe konglomeratet të lidhura në mënyrë të dobët. Këto sendimente shtrihen nëpër formacionet e lashta, me shtresim horizontal. Në sipërfaqe pjesërisht janë rimbulluar me proluvium.

Proluviumi paraqitet në fushën e Dibrës dhe të Banishtit, përfaqësohet me material gjysëm të rrumbullakët ose të rrumbullakët në rrethin e drejtpërdrejt të malit Deshat, kurse pak më larg përbëhet nga materiali më i mirë: rëra, glina dhe e rëra e glina.

Shpatijet e malit Deshat në pjesën më të madhe janë të paraqitura me flish. Ky flish përbëhet nga glinat, rërat, laporcet dhe laporovitet, gëlqerorët dhe gëlqerorët. Flishi paraqitet në pjesën perëndimore të luginës, por në sipërfaqe shumë më të vogla.

Në luginën e Dibrës bashkohen tri lloje të dheut : me përbërje çimentore, poluviale-deluviale dhe aluviale.

Dherat me përbërje çimentore që zhvillohen në tarracën e liqenit në liqenin e dikurshëm të Dibrës paraqiten me disa varietete. Janë zhvilluar kryesisht në shtresat e trasha të sedimenteve neogjene. Karakteristikë e tyre është se i janë nënshtruar erozionit sipërfaqësor.

Në zonën e dherave çimentore, zhvillohen tokat poluviale-deluviale në të cilat shtrihet qyteti i Dibrës. Këto toka janë me përbërje heterogjene, ku është i ndjeshëm veprimi antropogjen.

Tokat aluviale zhvillohen në ripin e ngushtë në luginën e Drinit të Zi, kurse janë të përfaqësuara me disa varietete.

1.3 Karakteristikat hidrologjike

Karakteristikat klimaterike, orografike, të dheut, gjeologjike dhe karakteristikat e tjera, kanë kushtëzuar që pjesa më e madhe e sipërfaqes në Komunën e Dibrës të jetë e pasur me burime dhe rrjedhje ujore, kurse prania e tyre, lartësitë e larta dhe favorët morfologjike kanë bërë të mundur krijimin e Liqenit të Dibrës, ndërsa me këtë edhe mundësinë e krijimit të kapaciteteve hidroenergjetike dhe shfrytëzimin e energjisë potenciale të këtyre ujërave.


Liqeni i Dibrës është veçoria më e shprehur në kuptimin hidrografik në këtë hapësirë. Akumulimi i Spiles është formuar nga ujërat të dy lumenjve me shumë prurrje dhe me shumë karakteristika të mira hidrologjike-Drini i Zi edhe Radika me rrethimin e tyre, përkatësisht me ngritjen e digës të lartë 116 m. nga çakalli dhe bërthama prej glinës, përfshin sipërfaqe prej 13,20 km², dhe vëllim prej 520.000.000 m³, që shfrytëzohet për prodhimin e 300.000.000 KW orë energji elektrike.

Nga aspekti i karakteristikave hidrologjike, kuota maksimale arrin 585 m, kurse kuota minimale 560m. Thellësia më e madhe arrin 100 m, gjatësia e rrjedhjes së lumit Drini i Zi arrin 13 km, kurse e lumit Radikë 8 km, që paraqet sipërfaqe të liqenit. Oscilimi i nivelit është 25 m, gjatësia e bregut 46,5 km. Temperatura e ujit gjatë periudhës së dimrit arrin 10°C, kurse gjatë periudhës së verës 23°C. Të gjitha rrjedhjet ujore në hapësirën e komunës rrjedhin në drejtim të këtyre dy lumenjve ose në liqen.

Uji i Liqenit të Dibrës përveç se shfrytëzohet si potencial hidroenergjetik, paraqet potencial të rëndësishëm për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore (në tarracën e Dibrës dhe të Zhupës), si dhe për zhvillimin e turizmit. Brënda kësaj periudhe është ndërtuar stacioni i motopompave, i cili mund të ujitën deri 2000 hektarë sipërfaqe. Gjithashtu janë krijuar edhe

mundësi për zgjidhjen e problemit tjetër të ekonomisë ujore, siç është sigurimi i ujit industrial.

Në territorin e hapësirës që rregullohet kryesore janë derdhjet e poshtme të lumenjve Drini i Zi dhe Radikë. Drini i Zi rrjedh në gjatësi prej 18 km (përafërsisht 38 km nga kufiri i Komunës së Strugës deri në fillim të Liqenit të Dibrës, ndërsa nga diga e Spiles deri te zona kufitare 14 km). Para derdhjes së lumit Drini i Zi në Liqenin e Dibrës derdhen disa degë tjera, prej të cilave më të rëndësishme janë degët: Dollgash, Koxhaxhik, Vrashtice dhe Përroi i Breshtanit, si degë të djathta dhe Përroi i Trebishtës si degë e majtë. E vetmja degë pas digës është Përroi i Banishtit.



Radika është një nga lumenjtë me prurrje më të mëdha në Maqedoni, kurse në këtë pjesë është rrjedhja në pjesën e derdhjes së mesme dhe të poshtme të lumit-përgjatë rrjedhjes nga Banja e Kosovrastit nga kuota 580-485 m në lartësinë mbidetare. Gjatë rrjedhjes së mesme në këtë lum derdhen degët e lumit të vogël ose të lumit të Gajres, që është formuar nga burimi i Rosokut prej të cilit furnizohet me ujë qyteti i Dibrës nëpërmjet sistemit për furnizim me ujë të pijshëm. Kjo është dega më e madhe, ndërsa degët e tjera janë më të vogla dhe kanë ujë vetëm në rastin e shirave të mëdha ose gjatë shkrirjes së borës në malet Deshat dhe Stogovë.

Terrenet që i përfshin qyteti dhe rrethina e tij e drejtpërdrejtë, përveç tipeve të krijuara me ujë të bollshëm, u takojnë pjesës më të madhe të terreneve që kanë ujë me bollëk (deri 40 l./sek)-f. Elevcë, Banisht-përroi deri në 18 l./sek, Banisht-Kërçin deri 12 l./sek, Skudrinjë-deri në 20 l./sek, Kojnarë deri 5 l./sek, si edhe një numër

i madh i burimeve më të vogla prej 2-5 l./sek. Këto burime natyrore me kapacitet të ndryshëm bëjnë të mundur mbulimin me ujë të pijshëm të vendbanimeve në komunë. Qyteti i Dibrës furnizohet me ujë nga sistemi i furnizimit me ujë në burimin Rosok që ndodhet rënzë malit Bistra.

Në afërsi të qytetit të Dibrës paraqiten burime termominerale në dy zona burimore, ujëra të cilat mendohet se vijnë nga thellësitë e mëdha nga një rezervuar i përgjithshëm. Njëri është në afërsi të fshatit Banisht ndërsa tjetri para fshatit Kosovrast i Poshtëm. Në këto dy zona uji termal vjen në sipërfaqe nëpërmjet çarjeve dhe sistemit të plasaritjeve. Uji termomineral nga të dy burimet ka veçori mjekuese, gjë që ka kushtëzuar ndërtimin e objekteve rekreative në rrethinat e tyre.

Të dhënat themelore për këto ujëra janë si vijon:

- Banisht $D= 40 \text{ l./sek.}$ $T= 38^{\circ} \text{ C}$
- Kosovrast $D= 60 \text{ l./sek.}$ $T= 48^{\circ} \text{ C}$

Ujërat nëntokësore ekzistojnë në rrethin më të gjërë, por deritani nuk janë hulumtuar, por mbi bazën e gjermimeve të puseve niveli i këtyre ujërave lëviz nga 5 deri në 20 m. Ka mundësi që të zbulohen rrjedhje të reja të ujërave nëntokësore nga depërtimi i ujërave të Liqenit të Dibrës në zonat më të ulta afër shtratit të Drinit të Zi, tatëpjetë nga diga. Tashmë janë shfaqur ujëra nëntokësore në fshatin Kojnarë.

Mbi bazën e këtyre të dhënave të përmendura, favorët natyrore në krahasim me karakteristikat hidrografike janë shumë të volitshme edhe për vetë qytetin e Dibrës.

Në Komunën e Dibrës janë regjistruar 74 burime me prurje mesatare prej $0,124 \times 10^6$ m³/vit ose gjithsej $9,20 \times 10^6$ m³/vit.

Në luginën e Dibrës në sipërfaqe prej 8 km² është regjistruar fusha gjeotermale, ndërsa thellësia e kolektorit është 200 m, kurse temperatura 50⁰ C.

1.4 Karakteristikat tektonike

Tërmetet si dukuri seizmike janë fatkeqësi dominuese natyrore të cilat e karakterizojnë rajonin e Dibrës me aktivitet të konsiderueshëm, gjë që është e ndërlidhur ngushtë me karakteristikat tektonike të terrenit.

Pjesa më e madhe e çarjeve janë të lashta dhe të stabilizuara, por ka edhe të atilla që janë përtrirë sërish dhe janë aktivizuar si edhe plasaritje më të reja të cilat gjithashtu janë aktive.

Të dhënat historike tregojnë se tërmetet e fuqishme të gjeneruara në këtë territor janë të shoqëruar edhe me hazarde të mundshme kolaterale (shembje, gërryerje, plasaritje, çarje, zhvendosje) me shembje dominuese të cilat edhe më shumë i shtojnë pasojat negative nga tërmetet. Si më aktive u tregua çarja nëpër rrethin e Korabit, si rezultat i së cilës ndodhi tërmeti katastrofik në Dibër në vitin 1967. Njohuritë dhe kërkimet e deritashme tregojnë për ndikimin e dukshëm të tërmeteve të shkaktuar kryesisht nga vatrat epicentrale jashtë territorit të qytetit të Dibrës në largësi prej 30km. Në këtë mënyrë mendohet se pas çarjes që shtrihet në gjatësisë e Radikës janë shfaqur edhe burimet termale.

Terreni i basenit të Dibrës është hapësirë potenciale seizmike, ku mund të ndodhin tërmete prej 9° sipas SHMK, pas rrethit të afërt në basen deri 8° sipas SHMK, ndërsa në pjesët e tjera deri 7° sipas SHMK.

Pas tërmetit katastrofik të vitit 1967, ndërtimi seizmik dhe mbrojtja seizmike kanë zënë vend me përparësi në dispozitat teknike për projektimin dhe ndërtimin, si edhe masat përkatëse ekonomike për mbrojtjen e vlerave të krijuara (ndërrhyrja ndërtimore në konstrukcionin mbajtës në objektet ekzistuese për të krijuar rezistencë kundër tërmeteve më të fuqishme). Në vitet e kaluara normat janë modifikuar dhe përmisuar, kështu që sot ndodhen në nivelin më të mirë.

Në Republikën e Maqedonisë është bërë edhe rajonizimi makroseizmik i terrenit mbi bazën e kriterëve përkatëse (tërmetet lokalë, ndërlidhja tektonike etj.), është fituar vlera e kufirit maksimal në magnitudën e tërmeteve të pritura, si edhe instensiteti i përgjithshëm më afatgjatë i intenistetit të pritur maksimal të tërmetit.

Për shkak të mosekzistimit të rajonizimit të mikrorajonizimit seizmik, gjatë planifikimit dhe projektimit shfrytëzohet karta e rajonizimit makroseizmik, me çka terrenet natyrore jostabile dhe të pavolitshme në aspektin seizmik, nuk janë të përshtatshëm për aktivitet ndërtimore, kurse këto janë vendet ku zëvendësohen rrëshqitjet, formacionet gjeologjike, zonat e dislokimit, shembjet etj.

Sipas karakteristikave inxhinjierike të tokës, janë veçuar terrenet me kushte të ndryshme seizmike:

- Rajoni me kushte të volitshme seizmike shtrihet në malet Jabllanicë, Stogovë dhe Deshat, ndërsa janë ndërtuar nga shkëmbinjtë flish dhe gëlqero. Ato karakterizohen me ndijshmëri shumë të dobët seizmike.
- Rajoni me kushte seizmike të pavolitshme, me terrene seizmike të ndijshme shtrihet në pjesën jugore dhe jugperëndimore të qytetit të Dibrës. Mbi bazën e tërmeteve që kanë ndodhur deritani, janë bërë parashikime të tërmeteve të mundshme, sipas të cilave zonat seizmogjene përputhen me ato të përcaktuara deritani, përkatësisht territori që duhet të rregullohet i takon zonës me tërmete deri 9° sipas SHMK.

1.5 Reljefi

Fusha e Dibrës shtrihet në lartësinë mesatare mbidetare mbi 610 m. Nga veriperëndimi kufizohet me Kreshtën e malit Deshat, në perëndim fundin valëzues të fushës e ndërpret rrjedhja e Lumit Drini i Zi prej ku ngrihet mali Jabllanicë, ndërsa në juglindje shtrihet Liqeni i Dibrës-akumulimi i krijuar në luginën e lumenjve Radikë dhe Drini i Zi, pas kësaj ngrihet masivi i malit Stogovë. Në rrafshinat e Udovës të Epërme dhe të Poshtme, në zonën e shpateve jugore dhe jugperëndimore të malit Deshat (të njohura me emrin Kërçin) është vendosur qyteti i Dibrës.

Liqeni ndodhet në luginën e Dibrës në lartësi mbidetare 583,5 metra (në nivelin maksimal të ujit), që është 50 -100 metra më i ulët nga hapësira e rrafshirës së Dibrës dhe e rrafshënaltës së Zhupës së Epërme dhe të Poshtme.

1.6 Karakteristikat klimaterike

Lugina e Dibrës karakterizohet nga karakteristikat klimaterike specifike, sepse lugina është e mbrojtur nga malet përreth. Nëpër luginat e lumenjve Drini i Zi dhe Radikë ekziston qarkullim i vazhdueshëm i erërave. Nëpër rrjedhjen e Drinit të Zi dhe nëpër qafat e maleve shqipëtare ndihet ndikimi i klimës së Adriatikut, veçanërisht në muajt e verës dhe në tarracat më të ulta. Verërat janë të nxehta, ndërsa dimërat e ftohtë, kurse vjeshta është më e ngrohtë se sa pranvera. Ndarja vjetore e të reshurave nuk është e ekuilibruar. Të reshurat maksimale janë në muajt e vjeshtës dhe në muajt e hershëm të dimrit. Gjatë verës të reshurat janë minimale. Koha e vrenjtur në pjesën më të madhe është gjatë muajve të dimrit, kurse më pak në muajt e verës, gjë që është në kundërshtim me ecurinë e ditëve me diell. Dominojnë erërat nga drejtimi verior dhe verilindor.

Temperatura mesatare vjetore në Dibrë arrin 11,8⁰ C. Muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare prej 0,7⁰ C, ndërsa muaji më i ngrohtë korriku me 22,2⁰ C. Mesatarja vjetore e lëvizjes së temperaturës arrin 21,5⁰ C, gjë që paraqet vlerë mjaft të lartë e cila tregon se klima kontinentale ka ndikim thelbësor në regjimin e temperaturave në këtë luginë.

Temperatura mesatare dimërore është mbi 0 në tërë Fushën e Dibrës. Në vjeshtë është më ngrohtë se sa në pranverë. Kjo diferencë arrin 5,0⁰ C.

Ndikimi i klimës kontinentale, përveç rritjes mesatare vjetore të lëvizjes së temperaturës, reflektohet edhe në rritjen e vlerave ekstreme të temperaturave dhe në lëvizjen absolute të temperaturës në ajër që arrin 64,0⁰ C.

Në Fushën e Dibrës temperatura minimale absolute arrin -23,9⁰ C, ndërsa maksimalja absolute 40,1⁰ C, që është shënuar në korrik të vitit 1988.

Mesatarja vjetore e ditëve me diell në Luginën e Dibrës arrin 2.129 orë. Ndërsa mesatarja vjetore e ditëve të vrënjtura arrin 5,3 të dhjetat. Maksimumi në janar arrin 7,1 të

dhjetat, ndërsa minimumi 3,1 të dhjetat.

Sasia mesatare vjetore e të reshurave në Fushën e Dibrës është 872,2 mm. Më shumë të reshura ka në stinën e Dimrit, mesatarisht 278,4 mm. Të reshura diçka më pak ka në vjeshtë (258,3 mm), në pranverë 220,8 mm, ndërsa në verë ka më pak dhe arrijnë 113,7 mm. Itinerari i të reshurave bie në regjimin pluviometrik të mesdheut. Me të reshura maksimale në vjeshën e vonshme dhe në muajt e dimrit.



Lugina e Dibrës është me shumë erëra, më e shpeshtë është era që fryn nga veriperëndimi, me pjesëmarrje prej 164 % dhe shpejtësi mesatare vjetore prej 2,5 m/sek. Nga erërat e tjera me shpeshtësi më të shprehur janë erërat që fryjnë nga veriu dhe jugu.

2. Historia e bashkësisë

Ekzistimi i qytetit të Dibrës përmendet që në shekullin e V para erës sonë, ndërsa më vonë edhe në shekullin I të erës sonë nga Starboni dhe Plini, me emrin Dober, qytet i themeluar prej fisit Doberi. Ptolemeu në shekullin II të erës sonë e konfirmon ekzistimin e qyteti të quajtur Dober, Doberus ose Doboro dhe banorët e tij doberi.

Territori i Dibrës gjatë historisë ka qenë pjesë Dhespotatit të Epirit, Bizantit, e tjerë, ndërsa në shekullin e XIV nën Imperatorinë Otomane.

Gjatë periudhës së Gjergj Kastriotit Skënderbeut, Dibra është pozicionuar në vijën kufitare të konfliktit me turqit, dhe pjesa më e madhe e betejave të Skënderbeut kundër Imperatorisë Otomane është zhvilluar në këtë rajon (viti 1443-1465).

Dibra ka qenë qendër e shquar tregtare dhe zejtare, që ka luajtur rol të rëndësishëm në historinë e këtij rajoni. Deri në vitin 1912 Dibra ishte nga qytetet më të zhvilluara në rajon si në planin ekonomik, zejtar, tregtar dhe në planin kulturor dhe social. Në këtë periudhë Dibra numëronte 11.000 banorë dhe 462 dyqane.

Gjatë kohës së luftërave Ballkanike, përkatësisht në vitin 1913, qyteti u bë pjesë e Mbretërisë së Serbisë, ndërsa gjatë periudhës së luftës së Dytë Botërore Dibra u aneksua nga mbretëria e Italisë. Pas Luftës së Dytë Botërore me çlirimin e territorit të Maqedonisë edhe pjesa tjetër e territorit të Maqedonisë u bënë pjesë përbërse të Federatës së Jugosllavisë.

Për shkak të turbulencave dhe ngjarjeve të ndryshme në rajon Dibra e humbi pozicionin e vet, kështu që sot numërohet në mesin e rajoneve më të pazhvilluara në Maqedoni edhe

përkundër faktit se ka potenciale të volitshme për zhvillim.

Trashigimia kulturore e Komunës së Dibës është e pasur me objekte reprezentative dhe e dalluar për nga arritjet e larta në art dhe në krijimtari.

Nga objektet fetare islamike në Dibër statusin e trashigimisë kulturore e ka Xhamia e Hynqarit, e ndërtuar në gjysmën e dytë e shekullit të XV .Objekt më i lashtë fetar i traditës kristiane është kisha kushtuar Shën Varvarit në fshatin Rajçicë, e ndërtuar në vitin 1597.

Objektet profetike kanë rëndësi të konsiderueshme për nga vëllimi dhe rëndësia e atyre në trashigiminë kulturore të rajonit. Në suazat e strukturës urbanisitike të Dibrës ekzistojnë shumë objekte monumentale nga periudha të ndryshme të zhvillimit historik të vendit. Hamami i Vjetër që ka prejardhje nga shekulli i XVI dhe Hamami i Ri, i ndërtuar në periudhën e më vonshme, i bartin veçoritë e traditave klasike në ndërtimn e këtij lloji të objekteve. Pjesën më të madhe të ndërtimeve që e formojnë strukturën urbanisitike të qytetit paraqesin objektet e banmimit (shtëpitë), prej të cilave një pjesë e konsiderueshme i takojnë arkitekturës tradicionale nga shekulli i XIX.



Foto: Shtëpi me arkitekturë tradicionale

Në shpatijet juperëndimore të malit Stogovë ndodhet fshati Gajre që ka statusin e tërësisë së mbrojtur monumentale. I ndërtuar në 1100 metra lartësi mbidetare, është i vendosur në formë amfiteatri në drejtim të Lumit të Gajres, me arqitekturë të ruajtur karakterisitke për traditën miake të ndërtimit. Për këtë arsye mund të themi lirisht se fshati Gajre është një nga fshatrat më të bukura në Maqedoni.

3.RESURSET NATYRORE

Hapësira që zen qyteti dhe rrethina e tij e drejtpërdrejtë karakterizohet nga tre tipe të zonave: fundi i luginës, zona pyjore dhe kullotat e larta malore.

Pjesa e ultësirës së luginës përfshin pjesën e Fushës së Dibrës që është pjesë tipike agrare.

Zona pyjore e pjesës së maleve është ndarë në rajonin e pyjeve ahut dhe rajonin e pyjeve të dushkut. Në pjesët më të ulta në terrenet nga ahu, shpardi dhe shkola e bardhë. Përbri Liqenit të Dibrës pyjet janë degraduar dhe shndërruar në pjesë të zhveshura dhe në sipërfaqe të zhveshura dhe të punueshme, si pasojë e ekonomizimit të keq gjatë periudhës së kaluar. Këtu paraqiten pyje të ulta, të degraduara afër ahut dhe pyjeve të lejthisë, shkozës, blinit etj., ose shkurre tipike të përbëra në pjesën më të madhe nga dushku dhe shkola. Në pjesë të caktuara përjashtim nga kjo, përgjatë bregut të majtë të Drinit të Zi paraqiten sëipërfaqe ahu

me trung të ulët ose grupe të gështenjës së butë që meritojnë vëmendje të caktuar. Bregu i kundërt i Drinit të Zi është kryesisht me erozion të fuqishëm dhe pa vetegjacion, gjë që meriton vëmendje të posacme veçanërisht për shkak të mbrojtjes së liqenit.

Hapësira që përfshin qytetin e Dibrës dhe rrethinën më të gjërë ka një numër të madh pejsazhesh të llojlojshme, dinamike, të pasura me shumë vlera dhe bukuri të rëndësishme natyrore. Elementet themelore dhe vlerat hapësinore që e përbëjnë begatinë dhe karakteristikat e pejsazhit, rezultojnë me llojlojshmëri të reliefeve dhe me veçori topografike, me pasuri dhe komplekset të vegjetacionit dhe me rrjedhjet ujore.

Vend dominues në këtë zonë është mali Sotogovë (2273 m). Me interes të veçantë janë pjesët që gravitojnë në Drejtim të Lumit Drini i Zi, përkatësisht në drejtim të Liqenit të Dibrës, por nuk janë më pak interesante edhe pejsazhet rustikale nën majën e Denaricës (2018 m).

Mali Deshat me majën Kërçin paraqitet ngjashmëm me Stogovën. Ky dominon mbi qytetin e Dibrës. Dega e Deshatit në sipërfaqen e Banjës së Banishtit janë pjesë interesante të kësaj hapësire, ku burimet termominerale derdhen në pejsazhin agrar të Fushës së Dibrës.

Qyteti i Dibrës ndodhet në një nga tarracat lartë liqenit, që është komponenti më i rëndësishëm i pejsazhit. Akumulimi i madh i ujit në Liqenin e Dibrës është krijuar nga ujërat e lumenjve Drini i Zi dhe Radika, që përfshihet në pejsazhin e kësaj hapësire, dhe kontribon për përmisimin jo vetëm të kushteve mikroklimaterike në këtë hapësirë, por edhe për pasurimin e vlerave të pejsazheve natyrore.

Terreni i pjerrët që është kushtëzuar me ndryshimin e lartësisë ndërmjet tarracës në të cilën është vendosur qyteti dhe niveli i liqenit përbëjnë hapësirë interesante të pjesës së bregut, i cili me masat biologjike dhe teknike duhet të rregullohet, për tu arritur përshtypja vizuale complete.

Në territorin e Komunës së Dibrës ndodhet reliefi i vetëm i gjipsit në Republikë, i cili shtrihet në gjatësi prej 9 km. Minerali i gjipsit është i një cilësie të lartë me përmbajtje prej 99% gjips të pastër, gjë që për nga cilësia radhitet ndër të parët në botë.

Afër 4 km në lindje të Dibrës në afërsi të fshatit Rajçicë ndodhet shpella e njohur e gjipsit Allçia. Shpella paraqet pjesë të rezervave të mëdha të gipsit, përkatësisht kaverna e mbushur me gips kristal. Kristalet janë të tejdukshme qartë me çarje në dy drejtime dhe me madhësi të dukshme deri 7 m, gjë që jep bukuri dhe veçanti të jashtëzakonshme tashmë edhe në suaza evropiane.

Në territorin e Komunës së Dibrës burojnë burime termominerale në fshatrat Banisht dhe Kosovrast (të njohura qysh në shekullin e 13), ku janë ndërtuar objekte mjekuese banjore me rëndësi ndërkombëtare.

Liqeni i Dibrës është krijuar në zonën e derdhjes së lumenjve Radikë dhe Drini i Zi. Liqeni dhe malet përreth formojnë një pejsazh të jashtëzakonshëm, i cili në tërësi ka pamjen e një rrafshire të ngritur në qytetin e Dibrës, si edhe nga rruga që lidh Dibrën me Strugën.

Liqeni jep mundësi të jashtëzakonshme për mbajtjen e garave sportive në ujërat e qeta. Interesim të madh paraqet shfrytëzimi i plazheve gjatë periudhës së verës nga ana e banorëve vendas dhe e mysafirëve.

Liqeni ka sipërfaqe prej 13,2 km², me sasi të përgjithshme akumulimi prej 520 milion m³ ujë, që shfrytëzohet për prodhimin e 300 milionë KW orë energji elektrike, ndërsa një pjesë përdoret edhe për ujitjen e Fushës së Dibrës.



Liqeni Dibrës

Sipërfaqja e përgjithshme bujqësorë në komunë Dibër përfshin sipërfaqe prej 7.708 hektarë. Nga kjo, tokë e punueshme janë 2.578 hektarë ose 33.4%, kullota zënë sipërfaqet prej 1.694 hektarë ose 22.0%, ndërsa pyjet zënë 3.433 ha ose 44.6%.

Komuna e Dibrës, disponon me sipërfaqe agrare-bujqësore prej 2.286 ha, prej të cilave 90% është në pronësi private kurse 10% në pronësi shtetërore. Kullotat zënë sipërfaqe prej 3.940 hektarë, kurse pyjet 5.980 hektarë.

Pyjet në Dibër paraqesin pjesë të rëndësishme për ekosistemin ekologjik dhe për atraktivitetin turistik, ndërsa një pjesë e caktuar shërben edhe për ngrohjen e ekonomive shtëpiake. Me pyjet në komunën Dibër ekonomizon N.P. Pyjet Maqedonase, Sektori Stogovë-Dibër.

Të gjitha ekosistemet në Dibër mund të grupohen në më së paku gjashtë zona klimaterike-vegjetative dhe tokësore (sipas ndarrjes së Filipovskit, Rizovskit dhe Ristevskit 1996) ose gjashtë biome (sipas ndarrjes së Matevejevit 1995). Ndarrjet bashkëveprojnë njëra me tjetrën. Nëse dihet që në Maqedoni ekzistojnë gjithësej 8 ose 9 ripa (bioma) të këtillë, atëherë edhe njëherë fitohet përshtypja për begatinë e biodiversitetit në rajonin e Dibrës.

4. POPULLSIA

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2002 dhe mbi bazën e organizimit territorial të vitit 2004, në Komunën e Dibrës jetojnë 19.542 banorë me dendësi popullore prej 134,15 banorë/km². Nga numri i përgjithshëm i popullsisë në Komunë, në qytetin e Dibrës jetojnë 15.000 banorë, ndërsa pjesa tjetër në vendbanimet nëpër fshatra.

Në kuadër të Komunës ka 19 qendra banimi, prej të cilave 5 fshatra janë shpërngulur tërësisht (Bohmova, Kojnara, Taraniku, Shushica dhe Spasi).

Vend qendror dhe seli e Komunës është qyteti i Dibrës, kurse vendbanimet e tjera janë fshatrat: Banishti, Kosovrasti i Epërm, Kosovrasti i Poshtëm, Krivca, Otishani, Rajçica, Sollokiçi, Tatar Elevca, Ame, Mogorça, Zepishta, Osoji dhe Gajre.

Tabela 1: Numri i banorëve në Komunën e Dibrës

Vendbanime	Numri i banorëve
Dibra	14.561
Kosovrasti i Poshtëm	813
Kosovrasti i Epërm	818
Rajçica	131
Tatar Elevca	10
Krifca	9
Ame	135
Banishti	90
Spasi	32
Sollokiçi-Shullani	104
Zepishta	499
Otishani	530
Mogorça	1.794
Gajrja	10
Osoji	6
Gjithsej	19.542

Burimi: Enti Shtetëror për Statistikë, Regjistrimi i popullsisë në vitin 2002

Qyteti i Dibrës paraqet mjedis multietnik dhe multikultror, dhe nga ky aspekt mund të shërbejë së shembull i mirë për marrdhëniet e mira, bashkëjetesën dhe tolerancën e ndërsjellë të pjestarëve me përkatësi të ndryshme etnike ose religjioze.

Struktura nacionale e popullsisë është si vijon: 11.348 (58,07%) janë Shqiptarë; 3 911 (20,01%) janë Maqedonë; 2 684 (13,74%) janë Turq; 1 080 (5,53%) janë Romë; 0,11% janë Serbë; 0,01% janë Vllasë dhe 2,54% janë nacionalitete të tjera.

Urbanizimi dhe industrializimi i shpejtuar në Reoublikën e Maqedonisë, që zhvilloheshin në vitet e shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta të dekadës në shekullin e 20-të, kushtëzuan lëvizje të mëdha migruese në relacionin fshat-qytet. Këto lëvizje nuk e kapërcyen as rajonin e Komunës së Dibrës, veçanërisht fshatrat ishin përfshirë nga migrimi masovik, ishte e pranishme braktisja e fshatrave dhe vendosja në qendrat më të mëdha urbane.

Dukuria e shpërnguljes dhe e migrimit në Dibër është dukuri shumë e pranishme dhe e gjërë. Për arsye politike, ekonomike dhe sociale në 30 vitet e fundit afër 10.000 qytetarë u shpërngulën në SHBA dhe 2000 në vendet e Evropës Perëndimore, ndërsa ka edhe një numër të madh që punojnë përkohësisht në vendet e Evropës Perëndimore. Migrimi i popullsisë nga fshati – në qytet është evident, ndërsa nga aspekti urbanistik paraqet problem mjaft serioz, për shkak të ndërtimeve të shumta pa leje dhe qenrave të paurbanizuara të banimit. Probleme më të mëdha sociale me të cilat ballafaqohet popullsia lokale janë, papunësia, pozita e vështirë materiale, sociale dhe banesore.

Tabela 2: Krahu i punës i moshës prej 15 e më shumë vjeç dhe shkalla e papunësisë në Komunën e Dibrës

Lokacioni	Popullsia e përgjithshme	Krahu i punës	Të punësuar	Të papunësuar	Shkalla e papunësisë	Shkalla e punësimit
Komuna Dibër	19.542	5.825	2.417	3.408	59%	41%

Burimi: Enti Shtetëror për Statistikë, Regjistrimi i popullsisë në vitin 2002

Nga të dhënat e prezentuara mund të konstatojmë se shkalla e papunësisë në Komunë arrin 59%.

5. ARSIMI

Rrjetin shkollor për arsimin fillor në Komunën e Dibrës e përbëjnë tri shkolla fillore: SHF „Said Najdeni”, SHF „Vllazërim Bashkim”-Dibër me klasë edhe në fshatin Zepishtë dhe SHF „Riste Risteski” f.Kosovrast i Poshtëm me klasë në fshatrat Kosovrast i Epërm dhe Mogorçë.

Arsimi i mesëm në Dibër zhvillohet në Qendrën shkollore të mesme „Zdravko Çoçkovski”.



SHF „Vllazërim Bashkim”

Tabela 3: Institucionet arsimore dhe treguesit numëror krahasimor

Përshkrimi	Klasët ku mësohet në gjuhën shqipe	Klasët ku mësohet në gjuhën maqedonase
Shkolla fillore “Vëllazërim Bashkim”-Dibër	2006/2007 vit..-729 nxënës 2007/2008 vit..-766 nxënës 2008/2009 vit..-740 nxënës	2006/2007 vit.-439 nxënës 2007/2008 vit.-539 nxënës 2008/2009 vit.-518 nx.ënës
Shkolla fillore “Said Najdeni”-Dibër	2006/2007 vit..-687 nxënës 2007/2008 vit.-708 nxënës 2008/2009 vit..-673 nxënës	
Shkolla fillore “Riste Risteski” – f.Kosovrast i P.		2006/2007 vit.628 nxënës 2007/2008 vit.-658 nxënës 2008/2009 vit.-675 nxënës
Shkolla e mesme “Zdravko Çoçkovski”-Dibër	2008/2009god.-504 nxënës	2008/2009 vit..-273(maqedonas), 42(turq)
Institucioni parashkollor “Breshia”-Dibër	2006/2007 vit.87 fëmijë 2007/2008 vit..-94 fëmijë 2008/2009 vit..-110 fëmijë	2006/2007g vit.28 fëmijë 2007/2008 vit.10 fëmijë 2008/2009vit.-10 fëmijë

Burimi:Komuna Dibër

Në afërsi të qendrës shkollore të mesme „Zdravko Çoçkovski” në qendrën e banimit Venec 1 është vendosur konvikti i nxënësve i cili mban të njejtin emër. Konvikti i nxënësve disponon me 100 shtretër, përkatësisht 24 dhoma nxënësish.

Tabela 4: Popullsia e Dibrës e moshës prej 15 dhe më shumë vjeç sipas përgaditjes shkollore

Përgaditja shkollore	Numri i banorëve
Të pashkolluar	520
Me arsim fillor të pakompletuar	1.517
Me shkollë fillore	7.442
Me shkollë të mesme	3.497
Me shkollë të lartë	487
Me shkollë të lartë, fakultet, akademi	649
Me magjistraturë	15
Me doktoranturë	10
Gjithsej	14.198

Burimi: Enti Shtetëror për Statistikë, Regjistrimi i popullsisë në vitin 2002

Nga tabela e pasqyruar mund të konstatojmë se përqindja e popullsisë që ka kryer arsim të lartë është shumë e vogël (4,57%), ndërsa më e madhe është përpqindja e popullsisë në komunë që ka kryer arsim të mesëm, përkatësisht arsim fillor (77%).

Në krahasim me resurset njerëzore vlen të theksohet se momentalsiht 270 studentë të Komunës ndjekin studimet në 9 univerzitetet të ndryshme në vend dhe jashtë vendit, gjë që në masë të madhe do t'i kontribojë komunës.

6. SHËNDETËSIA

Në Dibër ekzistojnë institucione shëndetësore për trajtim parësor dhe dytësor (diagnostifikimi, mjekimi dhe hospitalizimi), që përbëhen nga këto reparte:

1. Pedijatria (ambulanca dhe specialistët)
2. Gjinekologjia (ambulanca dhe specialistët)
3. Kirurgjia (ambulanca dhe specialistët)
4. Reparti për sëmundjet e brendshme (ambulanca dhe specialistët)
5. ORL (ambulanca dhe specialistët)
6. Oftamologjia (ambulanca dhe specialistët)
7. Dermatologjia (ambulanca dhe specialistët)
8. Dispanzeri për TBC
9. Shërbimet për dializë
10. Stomatologjia, laboratoriumi dhe shërbimet e rentgenit

Qendra mjekësore është vendosur në qendër të qytetit. Ka në dispozicion 65 shtretër në përbërje të 4 reparteve specialistikë.

OPSH Qendra Medicinale –Dibër nëpërmjet ambulancave i mbulon fshatrat e Komunës së Dibrës dhe të Komunës Qendra e Zhupës. Në territorin e Komunës së Dibrës në vendbanimet Kosovrast i Poshtëm, Zepishtë dhe Mogorçë, funksionojnë ambulancat që janë në kompetencën e kësaj qendre.



Qendra Medicinale –Dibër

Në qytet kohëve të fundit aktuale janë ambulancat (e përgjithshme, specialistike, dentare etj). Që janë në pronësi private.

Institucionet shëndetësore private në Komunën Dibër:

- Alba Med – ordinancë OPSH
- Dafina-OSHD Dibër
- Medi Bler-OQ-Dibër
- Pedijatria-OSHD
- Shëndetësia-OP- Kosovrasti i Poshtëm
- Heart Diagnostika-ord.
- Florina Rusi Marke-Fondacioni për diagnostifikimin e kancerit

Në kuadër të qytetit të Dibrës ekzistojnë gjashtë farmaci.

7. INFRASTRUKTURA

Lidhja e qytetit të Dibrës me rrugë komunikacioni me pjesët e tjera të Maqedonisë realizohet nëpërmjet rrugëve rajonale R-409 me Hanet e Mavrovës-Dibër-kufiri me Republikën e Shqipërisë (Bllatë) dhe R-418 (Strugë-Dibër). Ekziston edhe një rrugë tjetër komunikacioni R-415 (Ura e Boshkut-Izvor), e cila nuk është ndërtuar plotësisht. Dy drejtimet rrugore rajonale R-409 dhe R-418 që ndahen nga drejtimi rrugor magjstral M-4 sipas dy korridoreve natyrore, përkatësisht luginave të lumenjve Drini i Zi dhe Radika, bëjnë të mundur lidhjen dhe komunikimin me qytetin e Dibrës si edhe me vendbanimet dhe komunat fqinje, ashtu edhe me pjesët e tjera në brendësi të Republikës.

Rrugët lokale që e lidhin qytetin me vendbanimet janë të asfaltuara dhe të rikonstruara.

Rrugët lokale:

- | | |
|--------------------------------|----------|
| • Të asfaltuara | 39.49 km |
| • Të shtruara me pllaka betoni | 20.5 km |
| • Makadam | 37,00 km |
| • Të shtruara me dhe | 6,00 km |
| • Të pahapura | 2,00 km |

- Gjithsej 104.99 km

Rrugët rajonale në rajonin e Komunës Dibër :

- Rruga rajonale -R-409 (Ura e Boshkut-Vendkalimi kufitar Shqipëri): L=15 km
- Rruga rajonale -R-415 (Ura e Boshkut-Gajre): L=9,95 km
- Rruga rajonale -R-418 (drejtimi Dibër-Strugë): L=20 km
- Rruga rajonale -R-411 (drejtimi Banisht): L=2,7 km

Urat në rajonin e Dibrës:

Ura e vetme në kuadër të rrugëve lokale është ura ndërmjet Kosovrastit dhe rrugës rajonale R-409: L=30 m.

Në rajonin e Dibrës ka 17 ura në kuadër të rrugëve rajonale:

Urat në R 409:

- Ura e Boshkut: 20m
- Ura e Mollniçanit të Poshtëm: 28 m
- Mollniçan: 368,7m
- Gjat: 40,4 m
- Gjat: 42,4 m
- Gjat:25,2 m
- Gjat: 22,7 m
- Rajçicë ultësira: 69 m
- Dibër ultësira: 118,4 m
- Vakofi ultësira: 7,1 m

Urat në R-418:

- Përroi i Trebishtës: 153,9 m
- Përroi Vërvniçka: 97,02 m
- Gjatësia: 54,7 m

Urat në R-11

- Përroi Beleshnicë ndërmjet Mogorçës dhe Osojit
- Gjatësia: 7.55 m
- Përroi i Gajres :8.1 m
- Përroi i Jamës :10 m

Forma më e shpeshtë e transportit të organizuar të popullsisë është transporti me taksi (me vetura të lehta dhe furgonë).

Është interesante se në komunë nuk ka terminal të vendkalimit kufitar „Bllatë”, prandaj transportuesit dhe tregtarët duhet të udhëtojnë deri në Strugë (100 km në të dy drejtimet), gjë që në masë të madhe i rritën shpenzimet e transportit.

Komuna furnizohet me ujë kryesisht nëpërmjet burimeve. Furnizimi me ujë i qytetit të Dibrës kryhet nga burimi Rosok, që ndodhet 20 km larg qytetit. Nga ky burim kapen 200 l./sek dhe nëpërmjet rrugës gravituese shpërndahet deri te konsumatorët. Mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë e kryen Ndërmarrja Komunale Publike „Standard”-Dibër. Vendbanimet e tjera të Komunës së Dibrës i kanë sistemet e tyre për furnizim me ujë, menaxhimi dhe mirëmbajtja e të cilëve është në kompetencën e bashkësive lokale.

Qyteti i Dibrës disponon me kanalizimin fekal në të cilin janë kyçur më shumë se 90% e ekonomive shtëpiake. Pjesa tjetër prej 10 % ujërat e zeza i lëshojnë në teposhtëzat më të

afërta. Sistemi i kolektorit nuk është ndërtuar në tërësi, kështu që kanalizimi fekal lëshohet në teposhtëzat natyrore që gravitojnë në drejtim të rajonit të derdhjes në lumin Drini i Zi. Në vendbanimet është zgjidhur pjesërisht problemi me kanalizimin fekal dhe nuk janë ndërtuar stacione pastrimi.

Lidhur me furnizimin me energji elektrike Komuna e Dibrës ka në dispozicion rrjetin e shpërndarjes që ndahet në disa nivele të tensionit (35kw,10kw,dhe 0,4 kw) edhe atë në rrjetin kablovik /nëntokësor dhe ajror/nëntokësore.

Ky rrjet bën të mundur furnizimin pandërprerje me energji elektrike në tërë territorin e Komunës së Dibrës. Komuna e Dibrës ka në dispozicion rrjetin e telefonisë fikse cilësore, tri operatorë mobil, televizionin kabllorik, shpërndrësit e internetit: ADSL,rrjetin ajror, lidhjen kabllorike dhe të internetit.

8. PLANI URBANISTIK

20 vitet e fundit karakterizohen nga migrimet masovike të popullsisë në relacionin fshat-qytet për arsye sociale-ekonomike dhe politike. Për shkak të zhvillimit urbanistik të pa kontrolluar janë ndërtuar qendra banimi të tëra, siç janë Kojnara e re afër 40 ha,Taraniku afër 15 ha dhe pjesë të tjera në periferinë e qytetit të Dibrës.

Në vitin 2004 për qytetin e Dibrës u nxorr Plani Gjeneral Urbanistik (PGJU) me të cilin është përfshirë një sipërfaqe prej 415 ha. Me planet detale urbanistike është mbuluar 60 % të territorit të përfshirë me PGJU.

Komuna nxjerr edhe programe vjetore për hartimin e planeve urbanistike. Qendrat e reja të banimit Venec-1 dhe Venec-2 dhe Qernanica janë ndërtuar sipas planit urbanistik të pajisura me të gjitha objektet infrastrukturore.

Pjesë atraktive për urbanizim paraqet bregu i Liqenit të Dibrës, ku sipas PGJU është parashikuar ndërtimi i përmbajtjeve sportive-rekreative, i plazheve të rregulluara,i objekteve hotlierike, i hoteleve, vilave dhe përmbajtjeve tjera.

Me interes për zhvillimin ekonomik lokal janë hartuar dy plane urbanistike jashtë vendbanimeve- plani urbanistik për kompleksin ekonomik në lokalitetin “Voshishte”, kompleksi banjor “Kosovrast” të dy në rajonin f.Kosovrast i Poshtëm.

Vendbanimet nuk janë të mbuluara me plane urbanistike, po për ato është nxjerrë akti i përgjithshëm për kushtet dhe mënyrën e ndërtimiti. Pritet që Komuna për një periudhë të shkurtër kohore të hartojë plane urbanistike për vendbanimet më të mëdha ku ndërtimi shënon tendencë në rritje, siç janë Kosovrasti i Poshtëm, Kosovrasti i Epërm, Mogorça, Zepishta, Otishani dhe Banishti.

9. PUSHTETI QËNDROR

Në Komunën e Dibrës strukturat e pushtetit qëndror përfaqësohen me pushtetin ekzekutiv dhe gjyqësor.

Nga pushteti ekzekutiv dhe administrata shtetërore në Dibër ekzistojnë këto njësi:

1. NJR e Ministrisë për Financa dhe –Drejtoria për të hyrat publike
2. NJR e Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale
3. NJR e Ministrisë së Drejtësisë
4. NJR e Ministrisë për Mbrojtje
5. NJR për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës
6. NJR e Ministrisë së Shëndetësisë

7. NJR e Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonomi Ujore
8. NJR e Ministrisë për Ekonomi
9. Qendra për Mbrojtje Sociale
10. Fondi për Sigurim Shëndetësor
11. Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor
12. Agjensioni për Kadastër dhe Pasuri të Paluajtshme
13. Agjensioni për Punësim
14. Agjensioni për Zhvillimin e Bujqësisë Individuale

Në kuadër të Komunës njësitë e tyre rajonale i kanë edhe këto ndërmarrje shtetërore publike:

1. HC Spile
2. Posta e Maqedonisë
3. Ndërmarrja Pyjore NPEP Stogovë
4. Makedonija Pat

Segmenti i sistemit të jurisprudencës është i pranishëm në Dibër dhe përbëhet nga: gjykata themelore, prokuroria themelore publike, ndërsa për nevojat e popullsisë së Komunës së Dibrës shfrytëzohen edhe shërbimet e Avokatisë Publike nga Struga.

10. VETËQEVERISJA LOKALE

Komuna e Dibrës Dibër paraqet njësinë e vetëqeverisjes lokale me seli në Qytetin e Dibrës.

Organet e Komunës janë Këshilli i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Dibrës. Këshilli i Komunës është organ i përfaqësimit të qytetarëve dhe numron 15 anëtarë, të cilët në përbërje të tanishme përfaqësojnë 8 parti politike. Kryetari i Komunës e prezanton dhe përfaqëson komunën si organ ekzekutiv.

Për kryerjen e punëve me kompetencë të komunës, administrata e Komunës është ndarë në dy sektorë:

1. Sektori për rabanizëm, mjedis jetësor dhe punë komunale është organozuar në : sektorin për urbanizëm dhe mjedis jetësor dhe sektorin për punë komunale.

2. Sektori për punë të përgjithshme dhe juridike, për buxhet, financa, për zhvillim ekonomik lokal dhe për bashkëpunim ndërkufitar është organizuar në dikasterin për punë të përgjithshme dhe juridike dhe në dikasterin për buxhet, financa, zhvillim ekonomik lokal dhe bashkëpunim ndërkufitar.

Administrata komunale ka gjithësej 49 të punësuar, prej të cilëve 17 nëpunës shtetërorë dhe 22 të tjerë të punësuar në administratën publike.

Tabela 5: Shkalla e arsimimit të kuadrit të Komunës

Arsimimi	Numri I të punësuarve në komunë
Me arsim fillor	6
Me arsim të mesëm	18
Me arsim të lartë	21
Magjistra	0
Të tjerë	4
Gjithsej	49

Burimi: Komuna Dibër

Në Komunën e Dibrës ekziston Ndërmarrja Komunale Publike (NPK) „Standard”, e angazhuar për kryerjen e veprimtarive themelore komunale në Komunë, që don të thotë se kryen furnizimin e ekonomive shtëpiake dhe të subjekteve ekonomike me ujë të pijshëm, mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit dhe mbledhjen, transportimin dhe vendosjen në deponi të mbeturinave komunal. Ndërmarrja Komunale Publike „Standard” ka mbi 85 të punësuar dhe është e vetmja ndërmarrje që merret me këtë veprimtari. Në territorin e Komunës së Dibrës është organizuar edhe Njësia për mbrojtjen kundër zjarrit e cila ka 11 të punësuar.

11. EKONOMIA

Me fillimin e procesit të decentralizimit fiskal dhe të kalimit të kompetencave të reja nga niveli qendror në nivelin lokal, u ritën të hyrat buxhetore mbi bazën e taksave komunale, por për të ndikuar në drejtim të përmisimit të politikës lokale të komunës, është e domosdoshme që të zgjidhet edhe statusi i truallit dhe pjesa e koncesioneve për resurset natyrore.

Industria është promotori kryesor i proceseve zhvillimore në ekonominë e Komunës, por si rezultat i proceseve të transicionit kjo degë ka humbur intensitetin për shkak të numrit të madh të kapaciteteve që janë mbyllur ose që punojnë në kushte shumë të vështira.

Bartësit kryesor të ekonomisë në Komunën e Dibrës janë: SHA “Knauf Radika” (fabrika për prodhimin e gjipsit dhe të parafabrikateve të gjipsit; SHA “Deplast” (fabrika për prodhimin e prodhimeve të ndryshme prej plastikës); HC “Spile” (hidrocentrali), “Isen Komerc” (fabrika për prodhimin e brumërave), “Eurogjipsi” (gjips), “Ready mix-Korabi” (baza betonike) dhe kapacitete të tjera prodhuese më të vogla.

Në lëmin e turizimit në nivel komunal është zhvilluar turizmi banjor, bartës i të cilit është OPSH “Banjat e Dibrës- Capa” me më shumë e 150 të punësuar dhe me kapacitet për vendosje prej 700 shtretërve në hotelet në f.Kosovrast dhe f.Banisht dhe në hotelin “Venec” në Dibër. Ujërat termominerale janë të shquara dhe numërohen ndër ujërat më të njohura banjore mjekuese në Evropë dhe në botë për mjekimin e sëmundjeve të ndryshme.



Banja në f.Banisht

Si rezultat i pozitës së volitshme gjeografike të këtyre banjave me lartësi mbidetare prej 600 m (f.Kosovrast) në afërsi të Liqenit të Dibrës, përkatësisht 900m. Lartësi mbidetare (f.Banisht), ekzistojnë mundësi reale për zhvillimin e turizimit liqenor, malor dhe të fshatit.

Liqeni i akumuluar “Spile” bën pjesë në grupin e hidrocentraleve më produktive në Maqedoni me më shumë se 300 milionë kw/h në vit. Konfiguracioni i terrenit që krijon kushte për shfrytëzimin e ujërave të lumenjve, paraqet një potencial të madh për ndërtimin e minicentraleve për prodhimin e energjisë elektrike.



Hidrocentrali- "Spile"

Në të kaluarën bujqësia ishte degë e rëndësishme ekonomike në këtë rajon, por për shkak të mundësive të kufizuara ajo nuk mund të jetë bartëse e zhvillimit të Komunës. Në sferën e bujqësisë Dibra është vend i njohur për kulturat e drithërave (gruri, elbi dhe thekra), për kulturat për ushqimin e kafshëve (misri, jonxha, farërat barishtore) dhe për kulturat e perimtarisë (patatja, lakra, fasulja dhe të tjera). Është me rëndësi edhe prodhimi dhe përpunimi i tradicional i farës të jonxhës-varianteti i Dibrës (prodhimi vjetor mund të arrijë deri në 100 tonelata).

Blegtoria është shumë e përhapur për faktin se komuna është e njohur për nga sipërfaqet e mëdha të kulturave foragjere dhe të sipërfaqeve të mëdha të kullosave malore në afërsi të derjtëpërdrejtë të Komunës. Numri i përgjithshëm i lopëve arrin 1.400 kokë dhe numri i deleve afër 20.000 kokë dele. Rajoni i Dibrës e prodhon djathin specifik të dhenve me cilësi të lartë, i cili në kontekstin ekonomik paraqet nxitje për organizimin, standardizimin dhe brendimin më të mirë të këtij produkti si edhe të prodhimeve tjera qumështore. Kohëve të fundit është në rritje zhvillimi i bletarisë për shkak të kushteve të jashtëzakonshme natyrore që i posedon rajoni i Dibrës.

12. KULTURA DHE SPORTI

Në Qendrën për Kulturë "Shkupi" janë bashkuar shumë funksione: biblioteka e qytetit, salla për kinema dhe shfaqje teatrore, hapësira për veprimtari kulturore, artistike dhe zbavitëse, amfiteatri dhe restoranti.

Në Dibër funksionojnë shoqatat kultruore dhe artistike "Haki Stërmilli" dhe "Dibra" si edhe Teatri i dramës "Qemal Ajdini".

Festivali tradicional teator-i dramës mbahet gjatë periudhës së verës, në të cilin me shfaqjet e tyre marrin pjesë shtëpi teatrore nga Maqedonia, Shqipëria, Kosova dhe vendet tjera.

Në kuadër të manifestimit "Vera kulturore" mbahen aktivitete të ndryshme kulturore, koncerte, gara sportive, mbrëmje poetike, dita e shalqirit, dasma rome dhe aktivitete tjera.

Në Dibër funksionojnë disa klube sportive prej të cilëve më i vjetri është Klubi futbollistik "Korabi", i cili garat i zhvillon në ligën rajonale. Klubi i kajakut "Radika" është ndër tre klubet më të suksesshme të kajakut në Maqedoni. Ky klub ka arritur suksese të mëdha në garat shtetërore dhe ndërkombëtare, ndërsa sportistët e këtij klubi bëjnë pjesë edhe në përbërje të reprezentacionit të Republikës së Maqedonisë për kajak.



Klubi i kajakut

Në kuadër të Komunës ekzistojnë edhe dy klube të basketbollit për junior dhe senior, të cilët në radhët e tyre numërojnë më shumë se 80 fëmijë dhe të rinj.

13. SEKTORI QYTETAR

Me seli në Komunën e Dibrës janë regjistruar afër 50 shoqata joqeveritare, të cilat veprojnë në fusha të ndryshme : nisma qytetarësh, mbrojtja e të drejtave të grave, mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor, kultura, aktivitetet humanotare, edukimi, nismat rinore, bujqësia, pensionistët, invalidët rupor , grupet e marginalizuara etj.

Organizatat joqeveritare më aktive janë: "Qendra për zhvillim të qëndrueshëm në bashkësi", Shoqata Ekologjike "Deshati", Qendra e gruas, Shoqata sportive e peshkatarëve "Trofta", "1 dollar për Dibrën", "Rinia tolerante", "Hëna" etj.

Sektori joqeveritar nëpërmjet projekteve vetanake dhe projekteve që realizohen në bashkëpunim me instituconet e tjera, në masë të madhe kontribuon në ngritjen e vetëdijes publike të qytetarëve, në promovimin në pjsëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes dhe në forcimin e shoqërisë demokratike.

RAPORT I VLERSIMIT TË GJENDJES SË AMBIENTIT JETESOR NË KOMUNËN E DIBRËS

Gjendja e vlerësuar e mjedisit jetesor në Komunën e Dibrës është bërë mbi bazën e metodologjisë (DPSIR). Nëpërmjet kësaj metode analizohet ndërlidhshmëria ndërmjet trysnive (presionit) që i kryejnë forcat lëvizëse ndaj mjedisit jetesor, gjendjes së ndryshuar të mjedisit jetesor dhe hapave që duhet të ndërmerren për tu zvogëluar trysnia (ndotja) ndaj mjedisit jetesor.

Metodologjia DPSIR (Driving force-forcës lëvizëse, Pressure-trysnisë, State-gjendja, impact-ndikimi, reponse-përgjegjja/aksioni), mundëson që të përkufizohen forcat lëvizëse që ndikojnë në mjedisin jetesor, presioni i cili e modifikon gjendjen e medimeve ndaj mjedisit jetesor, gjendjen e tanishme dhe ndikimin si edhe përkufizimin e përgjegjies-aksionit përkatës për zgjidhjen e problemeve. Metodologjia pasqyron lidhjen e shkakut-pasojës dhe ndihmon në procesin e marrjes së vendimeve nëpërmjet shqyrtimit të përbashkët të çështjeve ekonomike, sociale dhe të çështjeve nga lëmi i mbrojtjes së ambientit jetesor, duke shfrytëzuar me këtë rast treguesit e ndryshëm me të cilët në mënyrë më preçize pasqyrohet vartësia e shkakut-pasojës nga dukuritë sociale-ekonomike në mbrojtjen e mjedisit jetesor.




Foto: Prezentimi DPSIR metodologjisë

Vlerësimi i gjendjes së mjedisit jetësor është realizuar nëpërmjet këtyre fazave:

- Përgatitja e diagramit DPSIR për lëmenjtë tematikë: natyra, mbeturina, ujërat dhe resurset ujore, ajëri, përdorimi i truallit dhe i tokës;
- Grumbullimi i të dhënave dhe i informatave;
- Përkufizimi dhe zgjedhja e një grupi të treguesve;
- Krahasimi i të dhënave me gjendjen e ambientit jetësor me standardet dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- Përgatitja e raportit me problemet nga lëmi i ambientit jetësor .

1. LËMIA TEMATIKE MBETURINAT

Sipas të dhënave të mara nga Ndërmarrja Komunale Publike "Standard"-Dibër, sasia e mbeturinave të mbledhura gjatë vitit 2007 arrin: afër 3.900 tonelata mbeturina komunale dhe mbeturina tjera të parrezikshme, 3.400 m³ mbeturina të parrezikshme industriale, kryesisht nga fabrika Knauf-Radika (dihidrat gjipsi dhe karton), 6000 m³ mbeturina inertesh dhe 15 tonelata hedhurina nga automjetet e aksidentuara dhe lloje tjera mbeturinash. Gjatë vitit 2007 NKP "Standard" nënshkruajti marrëveshje me firmën private nga Shkupi, për heqjen e automjeteve të aksidentuara.

Tabela1-Të dhëna për sasi të mbeturinave sipas viteve (NKP"Standard"-Dibër)

	viti	Mbeturinat e grumbulluara tonelata
1	2004	3600
2	2005	3700
3	2006	3800
4	2007	3900

Në Komunën e Dibrës funksionon Ndërmarrja Komunale Publike e themeluar në vitin 1953, e cila kujdeset për grumbullimin, transportin dhe vendosjen në deponi të mbeturinave komunale. NKP e grumbullon mbeturinat nga 3751 ekonomi shtëpiake, si edhe nga 890 persona të regjistruar juridik në territorin e qytetit të Dibrës, të 2 hoteleve dhe të një objekti hotelorik në periferi të qytetit.

Çmimi i shërbimit për grumbullimin e mbeturinave është kategorizuar si mëposhtë:

Tabela2:Çmimi për grumbullimin e mbeturinave:

Tarifa për m ²	Den/m ²
Për ekonomitë shtëpiake	1,0
Për personat juridik	3,7

Shkalla e arkëtimit të shërbimeve për mbeturinat komunale arrin afër 70%, me çka mbulohen vetëm shpenzimet vijuese operative.

Në qytetin e Dibrës, mbeturinat nga ekonomitë shtëpiake grumbullohet dhe transportohet dy herë në javë, ndërsa nga kapacitetet industriale dhe nga subjektet tjera sipas marrëveshjes, por më së shumti tri herë në javë.

NKP "Standard" për grumbullimin e mbeturinave komunale disponon me dy automjete

speciale dhe tre traktorë,t ë cilët janë të amortizuar dhe në gjendje të vështirë. Për grumbullimin e mbeturinave nga ndërtesat kolektive të banimit dhe nga subjektet e tjera janë vendosur 55 kontejnerë prej 1.1 m³ që janë blerë para 8 vitesh dhe pjesa më e madhe është në gjendje jo të rregullt. Numri i kontejnerëve me të cilët disponon NKP nuk i përmbushën nevojat e qytetit. Nga gjithsej 3600 ekonomi shtëpiake, 400 ekonomi shtëpiake posedojnë kosha të tipizuar për mbeturina prej 120 l.

Në qytet janë vendosur 150 kosha të vegjël për mbeturina prej të cilave 120 janë të dëmtuara. Koshat për mbeturina thyhen ose dëmtohen si rezultat i vetëdijes së ulët të qytetarëve.

Mbeturinat e grumbulluara komunale transportohet dhe vendoset në Deponinë e Qytetit,që ndodhet 2-3 km larg qytetit me sipërfaqe prej 1.2 ha. Deponia shfrytëzohet më shumë se 30 vite dhe ka kapacitet shfrytëzimi edhe për 10 vitet e ardhëshme. Lokacioni i deponisë ndodhet përbri rrugës rajonale Dibër-Vendaklimi kufitar Bllatë (Shqipëri).Deponia nuk i përmbushën standardet dhe parametrat e nevojshëm si deponi sanitare, sepse nuk është e mbrojtur nga aspekti fizik, nuk ka sistem kullimi dhe largimi te ujërave, si edhe masa të tjera teknike.Gjatë vendosjes së mbeturinaut nuk kryhet asçfarë seleksionimi.



Fotografia 1. Deponia e qytetit të Dibrës

Në deponi nuk ka pajisje adekuate dhe mekanizim për përpunimin dhe shtypjen e mbeturinave dhe për mirëmbajtjen e deponisë në gjendje të mirë. Shpesh herë kur fryn era mbeturinat shpërndahet nëpër sipërfaqet bujqësore fqinje, kurse ndonjëherë ka edhe ndezje të qëllimshme ose të pa qëllimshme të mbeturinave me ç'rast përhapet një aromë e keqe.

Nga mbeturinat e gjeneruara gjithsej në Komunë, 20% ose afër 950 tonelata (nga 12 qendra banimi me gjithsej 5032 banorë) mbeturinat nuk grumbullohet por hudhen përbri rrugëve, shtretërve të lumenjve, pyjeve, digjet ose hudhet nëpër sipërfaqet publike, me çka krijohen deponi të egra.

Në periferinë e qytetit janë evidentuar 7 deponi të egra.Më të mëdha janë dëponitë e egra të rregjistruara në lokalitetet Udovë dhe Venec, përbri rrugës në drejtim të Liqenit të Dibrës dhe përbri rrugës lokale për në fshatin Bohmovë, në lokalitetin "Progres",me gjithsej sipërfaqe të përfshirë prej 0.8 ha.

Situata alarmante është edhe nëpër fshatrat, veçanërisht në ato fshatra me numër më të madh të banorëve,te të cilët shkalla e shtimit të popullsisë është më e madhe në krahasim me vitin 2002 (për shembull në fshatin Mogorçë në vitin 2002 kishte 1794 banorë, ndërsa në vitin 2007, 1894 banorë, Kosovrasti i Poshtëm nga 813 në 1050, Kosovrasti i Epërm nga 818 në 897 banorë, Zepishta nga 499 në 642 banorë dhe Otishani nga 530 në 691 banorë).

Në këto qendra banimi mbeturinat hudhet nëpër sipërfaqe publike ose më shpesh në përrenjtë, luginat dhe pyjet.Në kushtet e shirave rebesh, mbeturinatu kalon në Lumin Radikë dhe në Liqenin e Dibrës, me çka jo vetëm që ndotet liqeni por edhe vjen deri te prishja e karakteristikave vizuale dhe të pejsazhit të këtij rajoni.



Fotografia 2. Deponia e egër në Kosovrastin e Poshtëm

Sa i takon mbeturinave të parrezikshme industriale në Komunën e Dibrës, prodhuesi më i madh i mbeturinave teknologjike është Fabrika për prodhimin e gjipsit dhe të prodhimeve të gjipsit AD "Knauf-Radika" (dihidrat gjips- karton). AD"Knauf" transportin e mbeturinave deri te deponia e qytetit e kryen sipas nevojës me automjetin e vet special. Në Dibër nuk janë regjistruar kapacitete tjera që nxjerrin mbeturina të rrezikshme. Në komunë më të pranishëm janë kapacitetet e ekonomisë së vogël, kështu që mbeturinat nuk i ka0235n karakteristikat të mbeturinave të rrezikshme dhe vendosen në deponi, në të njëjtin vend me mbeturinat komunale.

Mbeturinat që gjeneron nga institucionet mjekësore vendoset në deponi sëbashku me mbeturinaun e ekonomive shtëpiake. Mbeturinat mjekësore grumbullohet në mjete të posaçme që ndodhen në ambientet e spitalit.

Në territorin e Komunës Dibër nuk ekziston gropë për hedhjen e mbeturinave me prejardhje shtazore. Nga rasti në rast në deponinë e qytetit hapen gropa për kafshët e ngordhura , të cilat pastaj dezinfektohen dhe mbulohen.

Materialet inerte kohëve të fundit paraqesin problem për shkak të mosekzistimit të deponisë përkatëse për këtë lloj hedhurinash. Në largësi prej 2 km nga qyteti në rrugën që çon për në Liqenin e Dibrës është "caktuar" vend deponi për hedhjen e hedhurinave ndërtimore, të truallit dhe të inerteve, ku banorët në mënyrë të pavarur e hudhin këtë lloj mbeturinash që shkaktohet nga prishja e objekteve dhe nga gërmimet. Për lokacionin në fjalë ende nuk është marë vendim përkatës nga ana e vetëqeverisjes lokale. Komuna 2-3 herë në vit bën rrafshimin e këtij vendi për të krijuar mundësi për hudhjen e sasive të tjera. Përkundër kësaj në vende të caktuara, shpeshherë materialet inerte hudhen përbri rrugëve lokale dhe në shtretërit e lumenjve. Komuna me organizimin aksioneve në bashkëpunim me banorët lokalë kohë në kohë bën pastrimin e këtyre vendeve. Në rrugën që çon te Liqeni i Dibrës janë vendosur 2 tabela ku shkruhet se është e ndaluar hudhja e mbeturinave në këtë pjesë.

Inspektori komunal në përputhje me obligimet ligjore dhe me vendimin për rendin Komunal, kryen mbikqyrjen e rregullt të inspektimit në terren, si edhe mbikëqyrjen mbi bazën e deklaramentit të qytetarëve.

Në komunë nuk kryhet selektimi i mbeturinave, përkatësisht nuk është vendosur sistemi për selektimin e tipeve specifike të mbeturinave në përputhje me dispozitat ligjore. Kjo para së

gjithash ka të bëjë me mospajisjen profesionale dhe teknike përkatëse, si në Ndërmarrjen Komunale ashtu edhe në Komunë.



Fotografia 3. Deponia e egër në Rrugën për në Liqenin e Dibrës

Rezime e gjendjeve dhe problemeve në lëmin tematik MBETURINAT:

Gjatë vlerësimit të gjendjes së mjedisit jetësor për lëmin tematik MBETURINAT, janë shfaqur këto probleme që ndikojnë negativisht në mjedisin jetësor:

1. Nuk ekziston deponi qendrore sanitare komunale që do t'i përmbushte standardet e parashikuara ligjore;
2. 12 vendbanime nuk i marrin shërbimet për grumbullimin e organizuar të mbeturinave, gjë që rezulton me krijimin e deponive të egra;
3. Deponi joadekuate për hedhurinat inerte.
4. Mungesa e programit të vazhdueshëm për informimin dhe ngritjen e vetëdijes publike të qytetarëve;
5. Mekanizimi i amortizuar dhe joadekuate për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave;
6. Numri i pamjaftueshëm i kontenjerëve dhe i koshave për grumbullimin e mbeturinave në qytet;
7. Mosekzistimi i sistemit të organizuar për selekcionimin/ripërdorimin dhe përpunimin e mbeturinave të grumbulluara;
8. Trajtimi joadekuate i mbeturinave me prejardhje shtazore;
9. Krijimi i 7 deponive të egra në periferi të qytetit.

2.LËMIA TEMATIKE UJI

2.1 Resurset ujore në dispozicion

Një nga lumenjtë më të bukur në vendin tonë gjithsesi është lumi Radikë, adhuruese e peshkatarëve sportivë dhe e të gjithë atyre që preferojnë lum të pastër. Buron në 2200 m lartësi mbidetare në vendin e quajtur Vracë. Që nga burimi deri në grykëderdhjen në liqenin e Dibrës është i gjatë 67 km. Radika është i vetmi lum në Maqedoni i cili nëpërmjet degëzimit artificial e furnizon me ujë grykëderdhjen e Adriatikut dhe të Egjeut (Drini I Zi) (Vardari), nëpërmjet rrjedhjes së ujit nëpër sistemin hidrologjik Mavrovë dhe Vërben. Lumi Drini I Zi buron nga Liqeni i Ohrit në lartësi mbidetare 695 m dhe largohet nga Maqedonia në afërsi të Dibrës në lartësi mbidetare 476 m. Në territorin e Maqedonisë ky lum ka gjatësi prej 56 km.



Pas hidrocentralit Gllboçicë, ujërat e Drinit të Zi krijojnë edhe një liqe në digën me lartësi prej 102 m në afërsi të qytetit të Dibrës. Ky liqe artificial që është më i pasuri me ujë në Maqedoni, përkatësisht Liqeni akumulon 520 mil m³ ujë. Nga liqeni me ndihmën e tuneleve uji dërgohet në Hidrocentralin Spile. Në këtë moment ujërat e lumenjve shfrytëzohen maksimalisht dhe kjo paraqet potencial të hidroenergetik për Republikën e Maqedonisë. Dy hidrocentralet në Drinin e

Zi prodhojnë 580 Kwh energji elektrike në vit. Sipas informatave të Entit EHMR të Maqedonisë rrjedhjet mesatare vjetore gjatë periudhës së vitetve 1961-1990 për profile të veçanta më të rëndësishme janë dhënë edhe në tabelën që vijon.

Tabela 3. Rrjedhjet mesatare vjetore të analizuara brenda 30 viteve.

Lumi	Profili i ujit	Derdhja	RRJEDHJA Qsr	Rrjedhja specifike q
		km ²	(m ³ /s)	l/s km ²
Radika	Ura e Boshkut	751.0	19.68	26.2
Drini i Zi	Spile	4225.0	52.00	12.3

Për periudhën e viteve 2000-2003 është shënuar tendenca lineare në rënie e vlerave vjetore në vargun e rrjedhjeve vjetore minimale, mesatare dhe maksimale të Radika-Ura e Boshkut, me ç'rast rrjedhjet mesatare vjetore për periudhën e viteve 2000-2003 krahasuar me rrjedhjet mesatare të dhjetëvjetëshit më 1961-1970 arrin rreth 33.4% (raportet vjetore për ujin mund të shikohen në këtë webfaqe www.moep.gov.mk).

Në Komunën e Dibrës janë regjistruar 74 burime me prurje mesatare prej 0.124 *10⁶ m³/vit ose gjithsej 9.20*10⁶m³/vit. Nga kjo deritani kanë përfshirë me kaptazh 1.54 mil. m³/vit. Uji i shfrytëzuar deri tani nga pusët arrin 0.63 mil m³/vit, ndërsa potenciali i ujërave nëntokësore arrin 2.42 m³/vit (burimi i informatës nga JICA Studimi për menaxhimin e resurseve ujore në vitin 1999.

2.2 Cilësia e ujërave sipërfaqësore

Lumi Drini i Zi

Cilësia e ujit në Lumin Drini i Zi ndiqet në një vend për matje, nën HC Spile. Në përputhje me aktet ligjore, cilësia e caktuar e ujit është e klasës së II edhe gjatë periudhës së analizës (për 5 vitet e fundit-burimi EHMR) është tërësisht e kënaqshme.

Treguesit organoleptikë janë me vlera të klasës I si edhe vlera pH. Alkaliteti gjatë tërë periudhës së analizuar, i ka vlerat e klasës II.

Nga treguesit e regjimit të oksigjenit, oksigjeni i tretur ka vlerën prej 7.02-11.75 mg/l O₂, që don të thotë se më shpesh e ka vlerën për klasën I, kurse kohë pas kohe edhe për klasën II. Ngijshmëria e ujit me oksigjen i ka vlerat prej 70.8-119.5 %O₂-klasa -II-III, TBO5 të shumtën e rasteve e ka vlerën e klasës II. Konsumi kimik i oksigjenit e ka vlerën prej 0.24-1.37 mg/l O₂ dhe është me vlera që i takojnë klasës I.

Materiet e përgjithshme të tretura janë me vlera për klasën I, ndërsa materiet e suspenduara janë me vlera për klasën V-IV. Treguesit e eutrofikacionit nuk janë matur në këtë vend të matjes.

Treguesit kimik të ndotjes fekale janë me vlera për klasën I-II, vetëm joni i nitritit në një rast arrin vlerën për klasën e III-IV.

Materiet kimike-toksike janë me vlera për klasën I-II, me përjashtim të muajit prill, kur mangani ka arritur vlerat për klasën III-IV. Gjatë periudhës së analizuar kadmiumi më shpesh e ka vlerën për klasën I-II, kurse në muajt mars, qershor dhe gusht pasqyrohet me vlerën për klasën III-IV.

Lumi Radikë

Cilësia e ujit në Lumin Radikë ndiqet në një vend për matje te Ura e Boshkut dhe në përputhje me aktet ligjore cilësia e parashikuar e ujit është e klasës II. Nga matjet e kryera në 5 vitet e fundit cilësia e vlerësuar e ujit nuk ka ndryshuar, përkatësisht, të shpeshtën e rasteve është me vlerë për klasën I, ndërsa kohë pas kohe për klasën II.

Treguesit organoleptikë janë me vlera për klasën I, si edhe vlera pH. Alkaliteti është me vlerat të dëshmuara për klasën II.

Nga treguesit të regjimit të oksigjenit të tretur (prej 10.40-13.42 mg/l O₂) dhe konsumit kimik të oksigjenit (prej 0.32-1.47 mg/l O₂) janë me vlerët e dëshmuara për klasën I. Ngijshmëria e ujit me oksigjen shumë shpesh është me vlerat 97.4-143.2% O₂-e klasës I-II si edhe HBO₅, (prej 1-21-10-33 mg/l O₂).

Treguesit e eutrofikacionit nuk ndiqen në këtë vend për matje.

Treguesit kimik për ndotjen fekale dhe materiet kimike-toksike janë me vlerat për klasën I-II.

2.3. Furnizimi me ujë

Furnizimi me ujë në qytetin e Dibës kryhet nga burimi Rosok, që ndodhet 20 km larg nga qyteti. Nga burimi merren 200 l/s dhe nëpërmjet ujësjellësit shpërndahen te konsumatorët. Në sistemi e furnizimit me ujë janë kyçur këto shfrytëzues:

Tabela 4:(Shpërndarja e ujit dhe konsumi i pabarabartë)

Njësia matëse		Shpërndarja e planifikuar e ujit l/s	Shpërndarja momentale e ujit l/s
Vendbanimi Mogorçë		0.20	0.20
F.Kosovrasti i poshtëm		8,16	27.80
Konsumatorët komercialë (Knaufi, Seperacioni Dukas, Euro Gips, Korabi, Hoteli Termal)		2	2
Komuna e Zhupës		18.26	20
Dibra me fshatrat_(Solokiç dhe Spas)	Vb/f Rajçicë	1.08	150
	Zona e epërme	40	
	Zona e poshtme	130	

Nga tabela mund të kostatohet se në f.Kosovrat i poshtëm uji shfrytëzohet në mënyrë joracionale për ujitje dhe konsumohet 3 herë më shumë se sa që është parashikuar.



Fotografi nga burimi Rosok

Humbjet e ujit në sistem

Tabela 5. Pasqyra për ujin e faturuar dhe struktura për humbjet nga viti 2004 gjer në 8 muajt 2008 për qytetin Dibër.

	l/sek	2004	2005	2006	2007	2008 8 muajt	Mesatarja
		l/sek					
Uji i faturuar	200	34.95	33.42	34.80	38.22	41.88	36.65
	150	34.95	33.42	34.80	38.22	41.88	36.65
Humbjet dhe uji i pafaturuar	200	165.05	166.58	165.20	161.78	158.12	163.35
	150	115.05	116.58	115.20	111.78	108.12	113.34
% e ujit të faturuar	200	17.47	16.71	17.40	19.11	20.94	18.33
	150	23.30	22.28	23.20	25.48	27.92	24.43

Nga të dhënat mund të konstatohet se prej gjithsej 200 l/s ujë që merret në kaptazh (6.220.800,00 m³/vit) fakturohen 37 l/s.(1.150.848 m³/vit), përkatësisht faturohet më pak se 20% nga uji i prodhuar, ndërsa 80 % e sasisë nuk paguhet. Përqindja më e madhe e humbjes së ujit paraqet konsumin e papaguar gjatë periudhës verore(rreth 50 %), kur një pjesë e qytetarëve ujin e shfrytëojnë për të ujitur. Shkalla e pagesës së ujit të faturuar arrin 54 %.Mungesa e matësve të ujit, mënura e pagesës aprobe, faturat e papaguara në kohë dhe kyçësit e egër janë shkaqet më të rëndësishme për nivelin e ulët të pagesës.

Tabela 6: Pasqyra e ujit të konsumuar dhe pasqyra e humbjeve në sistem

Shembulli:Konsumi i ujit në qytetib Dibër (2006)			
Ekonomitë shtëpiake	m ³ /g	950,000	73%
Kompanitë	m ³ /g	350,000	27%
Konsumi i përgjithshëm:	m ³ /g	1,300,000	100%
Numri i banorëve të shërbyer:	b		15,875
Konsumi specific për një banor	l/d,b		224
Sasia e ujit të arritur	l/s		150
Struktura e humbjeve në sistem		m³/g	Struktura
Niveli i prodhimit		4,730,400	100.0%
Konsumi i paguar		1,300,000	27.5%
Konsumi i papaguar humbjet e përgjithshme		3,430,400	72.5%
Konsumi i pamatur gjatë verës(kalimi në		2,365,200	50.0%
Konsumi individual		212,868	4.5%
Humbje teknike (rrjedhjet)		851,472	18.0%

Humbjet e përgjithshme të ujit gjatë vitit 2004 arrijnë 68 %, ndërsa në vitin 2007 arrijnë 72,5 %. Nga tabela e sipërme mund të arrijmë në përfundim se 73 % e ujit shfrytëzohet nga ekonomitë shtëpiake me konsum mesatar prej 224-litra në ditë për një banor, normë e cila është diçka më e lartë se mesatarja 150-180 l/s sipas standardeve europiane.

Faktor tjetër i rëndësishëm me të cilin ballafaqohet NKP "Standard" paraqet humbja teknike (18% e humbjes së ujit që paraqitet për shkak të rrjetit të amortizuar në zonën qendrore të qytetit dhe që manifestohet me rrjedhje të vazhdueshme, ndërprerje dhe difekte të shpeshta në sistemin, gjë që rezulton me shpenzime të konsiderueshme për mirëmbajtje. NKP "Standard" siguron furnizimin me ujë të ekonomive shtëpiake, si edhe të subjekteve juridik-të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, të kompanive si edhe të vendeve më të vogla të shitjes me pakicë në qytetin e Dibrës. Sipas NKP llogaritë (faturat) mujore për ujin e konsumuar u dërzohen 50 institucioneve publike, organizatave dhe 300 kompanive më të vogla dhe bizneseve të shitjes me pakicë.

Sektori privat në Dibër në përgjithësi është mbuluar edhe me pagesën e ujit, por përqindja më e madhe paguhet sipas sistemit (aprofe), gjë që është e lidhur me gjendjen jo të rregullt ose me mungesën e matësve të ujit.

Në këtë moment çmimet për furnizimin me ujë arrijnë 11 mkd/m³ për ekonominë shtëpiake dhe 23 mkd/m³ për personat juridik.Korrigjimi i fundit i çmimit është bërë në muajin gusht të vitit 2004 kur u rrit për 30% që rezultoi me zvogëlimin e nivelit të pagesës.

Edhe përkundër faktit se qyteti i Dibrës disponon rregullisht me 140-160 l/sek,gjë që sipas të gjitha standardeve i plotëson nevojat e popullatës, megjithatë qyteti ballafaqohet me

problemin e furnizimit jo të rregullt me ujë gjatë periudhës së verës. Në rrjetin e ujësjellësit ka lidhje të egra dhe shfrytëzim joracional të ujit për ujitje dhe për qëllime tjera. Hapësira e rezervuarit në ujësjellësin e qytetit prej 750 m³ nuk i përmbushën nevojat për konsum të barabartë. Për këtë arsye gjatë periudhës së verës në qytet aplikohet rregjimi i kufizimit të shfrytëzimit me ujë, i cili për herë të parë filloi të aplikohet në vitin 2002.

Analizën për gjedjen e rregullt fizike-kimike dhe bakteorologjike të ujit të pijshëm e kryen OSHP EMSH në Ohër, NJO Dibër. Kontrolli i ujit në qytetin e Dibrës kryhet nëpërmjet marrjes së mostrave dy herë në muaj në vende të caktuara të matjes, ose 100 analiza në vit.

Në 5 vitet e fundit mund të konstatohet se uji i pijshëm është i cilësisë që u përgjigjet standardeve të caktuara në përputhje me rregulloren për gjedjen higjienike të ujit të pijshëm.

Furnizimi me ujë i vendbanimeve periferike

Vendbanimet tjera të Komunës së Dibrës, kanë sistemin e tyre të furnizimit me ujë menaxhimi dhe mirëmbajtja e të cilit është në ingerencat e bashkësive lokale. Sasia e përgjithshme e ujit të konsumuar vlerësohet në 220,000 m³/vit (norma mesatare e furnizimit me ujë 0,2 m³/d/b).

Tabela 7-Pasqyra e vendbanimeve, burimeve, e sasisë së ujit si edhe hapësira ekzistuese dhe e nevojshme e rezervuarëve.

Banisht	Ekziston kaptazh i pavarur në burimin lokal me sasi uji prej Q=8 l/s, gyp ujësjellës në gjatësi prej L=2km, rezervuari me V=40 m ³ dhe rrjeti i shpërndarjes.
Ame	Ekziston kaptazh i pavarur në burimin lokal, rezervuar me V=40 m ³ dhe rrjeti i shpërndarjes
Krifcë	Nuk ka sistem për furnizim me ujë. Furnizimi me ujë kryhet nga burimet locale-çezmat. Banorët janë shpërngulur, por ekziston kthimi i banorëve përkohësisht gjatë periudhës së pushimeve verore.
Sollokiç	Në përbërjen e tij ndodhen tri lagje: Sollokiçi, Shullani dhe Taraneshi. Shullani: Furnizohet me ujë nga Dibra nëpërmjet gypsjellësit Ø 125 mm në drejtim të vendaklimit kufitar Bllatë dhe ka rrjetin e shpërndarjes. Sollokiçi: Ekziston kaptazh i pavarur në burimin lokal me rezervuar prej V=20 m ³ . Taraneshi: Furnizohet me ujë nga burimi i pavarur lokal, çezma.
Otishani dhe Zepishta	Është ndërtuar sistem i pavarur për furnizim me ujë i cili përbëhet nga kaptazhi i vendosur në burimin "Manastirec" që ndodhet në largësi prej afër 10 km, me gypsjellës PE-ND 80 mm, rezervuar prej V=150 m ³ dhe me rrjet ujësjellësi.
Tatar Elevcë	Furnizimi me ujë kryhet nga burime lokale të pvarura-çezma. Banorët janë shpërngulur, por ata kthehen kohë në kohë gjatë periudhës së pushimeve verore.
Osoj	Ka sistem të pavarur të vetin për furnizim me ujë me rezervuar prej V=20 m ³
Mogorçë	Ekziston burim lokal i pavarur me kaptazh që ndodhet me largësi prej rreth 2 km, me gypsjellës Ø 80 mm, rezervuar prej V=70 m ³ dhe rrjet ujësjellësi. Ka filluar ndërtimi edhe i linjës së re prej F 150 mm dhe e rezervuarit prej 500 m ³
Gajre	Ekziston burim lokal i pavarur me kaptazh që ndodhet në largësi prej afër 800 m, me gypsjellës Ø50 mm, rezervuar prej V=15 m ³ dhe rrjet ujësjellësi.

Menaxhimi i sistemeve të furnizimit me ujë në vendbanimet rurale nuk është i përshtatshëm, sepse ato menaxhohen me vetë inisiativë nga vetë banorët lokale. Analizat e kryra deritani për cilësinë e ujit të pijshëm në këto vendbanime tregojnë se 40% nga numri i

përgjithshëm i mostrave të analizuara nuk i përgjigjet cilësisë së kërkuar. Kjo situatë vjen si rezultat i menaxhimit të pa përshtatshëm (nuk kryhet filtrimi, klorimi i ujit) dhe i mirëmbajtjes së sistemeve nga ana e banorëve lokalë.

Gjatë periudhës së viteve 2002-2006 në përputhje me të dhënat nga institucionet shëndetsore në Dibër dhe nga ambulancat private, nuk janë rregjistruar sëmundje, siç janë verdhëza ose sëmundje të zorrëve, për të cilat me siguri mund të thuhet se shkaktohen nga nodotjet bakteriologjike të ujit të pijshëm.

2.4 Mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të zeza

Ujërat e zeza komunale paraqesin problem të madh për mjedisin jetësor. Ujërat e zeza nga kanalizimet drejtpërdrejt derdhen në ujëmbledhësit (recipientët) sepse nuk ekziston asnjë stacion spastrimi.

Qyteti i Dibrës ka sistemin për kanalizimin fekal në të cilin janë kyçur 90% e ekonomive shtëpiake. Pjesa tjetër prej 10% ujrave të zeza i derdhen në ultësirat më të afërta. Sistemi i kolektorëve nuk është ndërtuar tërësisht, kështu që kanalizimi fekal derdhet në kanalet-ultësirat natyrore që çojnë drejt hapësirës së pellgut të lumit Drini i Zi.

Konfiguracioni i terrenit të qytetit të Dibrës e kushtëzon ndarjen e sistemit të kanalizimit fekal në dy, përkatësisht tre zona. Dy nga tre zonat gravitojnë në drejtim të lumit Drini i Zi dhe një në drejtim të Liqenit të Dibrës. Duke e shikuar terrenin, konfiguracionin e lartësisë, arrijmë në përfundim se ekziston mundësia që nëpërmjet rrugës së gravimit të kryhet lidhja e kolektorëve në një të vetëm, me çka do të mund të ndërtohej një stacion për trajtimin e ujërave të zeza.

Ujërat e zeza që në përgjithësi derdhen në ujëmbledhësit arrijnë 1.085.802 m³/vit, ndërsa ngarkesa e HBO₅ arrijnë 41.646 kg/vit. Në 5 vitet e fundit është e pranishme tendenca e rritjes së ngarkesës duke patur parasysh shkallën e rritjes së popullsisë në krahasim me numrin e banorëve në vitin 2002 si edhe rritjen e numrit të turistëve në tri vitet e fundit.

Ujërat e zeza me prejardhje industriale

Aktualisht burime të ujërave të zeza industriale janë këto kapacitete industriale.

- SHA "Knauf-Radika"-fabrika për prodhimin e gjipsit dhe të produkteve të gjipsit;
- SHA "Deplast"-fabrika për prodhimin e prodhimeve të ndryshme plastike;
- SHPKNJP "Isen -komerc"-fabrika për prodhimin e produkteve të brumërave;

Ujërat e zeza industriale drejtpërdrejt derdhen në sistemin e kanalizimit pa asfrë trajtimi paraprak. Objektet industriale nuk i kryejnë analizat e ujit që e derdhin. Në process e sipër është dhënia e lejes së integruar B për SHA "Knauf-Radika".

Ujërat e zeza nga kapacitetet turistike derdhen në ujëmbledhësit pa u spastruar. Në Hotelin Termal-f.Kosovrast i Poshtëm në vitin 2007 janë rregjistruar 3100 vizitorë dhe 25.000 buajtje, kurse ujërat e zeza derdhen në Liqenin e Dibrës pa një trajtim paraprak, ndërsa në Hotelin në Banjat e Dibrës-Capa në f.Banisht janë rregjistruar 32.00 vizitorë dhe 35.000 buajtje, kurse ujërat e zeza janë derdhur drejtpërdrejt në Përroin e Banishtit.

Në faturën për arkëtimin e shërbimeve komunale për ujin është përfshirë edhe çmimi i kanalizimit.

Tabela 8 Kanalizimi fekal në vendbanimet e tjera të komunës

Banishti		Ka një pjesë të rrjetit të kanalizimit që derdhet në ultësirat ekzistuese.
Ame		Derdhjet ekzistuese individuale kryhen në ultësirat më të afërta.
Krivca		Derdhjet ekzistuese individuale kryhen në ultësirat më të afërta.
Sollokiçi		Ka një pjesë të rrjetit të kanalizimit që derdhet në ultësirat ekzistuese.
Otishani Zepishta	dhe	Kanë një pjesë të rrjetit të kanalizimit që derdhen në ultësirat ekzistuese.
Mogorça		Ka pjesë të rrjetit të kanalizimit që derdhet në ultësirat ekzistuese. Në punë e sipër është ndërtimi i kolektorit që do të ndërlidh këto derdhje dhe do të çojë deri te sracioni i planifikuar i spastrimit, për të cilin janë hartuar projektet kryesore për kolektorin dhe stacionin e sapastrimit me teknologjinë SBR nga "Geing" Shkup.
Gajre		Nuk ka kanalizim, ndërsa secila ekonomi shtëpiake ujërat l derdhën në ultësirat më të afërta që gravitojnë në drejtim të lumit Gajre.
Rajçicë		Nuk ka kanalizim janë ndërtuar pjesë kanalizimi nga shtëpitë individuale por nuk janë prfshirë me rrjet kanalizimi, por në mënyrë të pavarur derdhen në ultësirat më të afërta të cilat gravitojnë në drejtim të liqenit të Dibrës.
Kosovrasti Poshtëm	i	Ekziston kanalizim fekal prej 1 625 m, l cili pa u spastruar derdhet në Liqeni e Dibrës.
Kosovrasti i epërm		Ekziston rrjet kanalizimi, janë ndërtuar pjesë të kanalizimit që derdhen në lugun që përfundon në lumin Radikë. Ka një të dhënë interesante se në Kosovrast të epërm ekziston kanalizim i formës së gjerizit që nuk është e verifikuar por që ekziston që nga kohët e lashta.

Sipas këtyre të dhënave në vendbanime vetëm pjesërisht është zgjidhur problem i kanalizimit fekal dhe nuk janë ndërtuar stacione spastrimi. Ujërat fekale nga vendbanimet Mogorçë, Kosovrast i Poshtëm dhe Kosovrast i Epërm nëpërmjet teposhtëzave ose drejtpërdrejt derdhen të pa spastruara në lumin Radikë dhe më pastaj në Liqenin e Dibrës, ndërsa nga fshatrat Zepishtë dhe Otishan ujërat fekale janë të drejtuara për në Liqenin e Dibrës.

Deri në vitin 2003 qyteti i Dibrës nuk kishte kanalizim atmosferik. Ujërat atmosferike



derdheshin nëpër sipërfaqe, ndërsa një pjesë e tyre kalonte nëpër kanalizimin fekal, me çka kryhej mbingarkim plotësues hidraulik i tubove.

Gjatë viteve 2003-2008 është ndërtuar një pjesë e kanalizimit atmosferik në gjatësi prej 2.800 m, me çka është zvogluar ndikimi negativ ndaj sistemit të kanalizimit fekal.

Fotografia 4. Derdhja e kanalizimit fekal në Lumin Radikë f. Kosovrast i Poshtëm

Për zgjidhjen e tërësishme të këtij problemi është e nevojshme të ndërtohet kanalizimi atmosferik parësor dhe dytësor, me çka do të përfshihen qendrat e banimit Venec 1, Venec 2, zona qendrore e qytetit dhe pjesa e vjetër e qytetit.

Drejtimi i kolektorëve për kanalizimin atmosferik përputhet me drejtimin e rrjedhjes së ujërave fekale dhe të zeza, kështu që në pjesën më të madhe të qytetit rrjeti i kanalizimit atmosferik dhe fekal mund të kalojnë paralelisht, me çka zvogëlohen sasisë e realizimit.

Rezyme për gjendjen dhe problemet në lëmin tematik UJI

- Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntoksore si rezultat i derdhjes së drejtpërdrejt të ujërave të zeza në ujëmbledhësin (receptientin);
- Mungesa e ujit të pijshëm si rezultat i rrjetit të amortizuar, humbjeve të mëdha të ujit dhe kyçjeve të egra në qytetin e Dibrës;
- Efektiviteti i ulët i NKP në ekonomizimin me sistemin e ujësjellësit (shkalla e ulët e arkëtimit, politika joadekuate tarifore për mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtje);
- Menaxhimi joadekuat me sistemet e ujësjellësit dhe të kanalizimit në 12 vendbanimet që nuk janë mbuluar me shërbime nga NKP;
- Bregu i liqenit nuk ka sistem për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të zeza të objekteve në bregun e liqenit dhe të qendrës së banimit Rajçicë;
- Kanalizimi i papërfunduar atmosferik në 60 % të territorit të qytetit të Dibrës.

3. LËMIA TEMATIKE-AJËRI

3.1 Ndotja industriale

Territori i Komunës së Dibrës nuk është përfshirë në rrjetin matës të RM për monitoringun dhe ndjekjen e cilësisë së ajrit, me të cilën janë përfshirë parametrat e dioksidit të karbonit, oksidet azotike, tymi etj.

Në Komunën e Dibrës nuk është zhvilluar industria e rëndë, përkatësisht nuk nxirren materie të dëmshme që do të ndikonin negativisht në ndotjen e ajrit. Gjithashtu nuk ka as kapacitete energjetike në territorin e komunës.

Sa i përket ndotjes së ajrit nga industria, burim më i rëndësishëm i ndotjes është fabrika për prodhimin e gjipsit dhe të nënprodukteve të gjipsit ASH"Knauf-Radika". Kjo fabrikë dallohet për nga sipërfaqja e madhe e saj në krahasim me subjektet e tjera të ekonomisë së vogël dhe zen sipërfaqe prej 9 ha. Lokacioni ndodhet në pjesën juglindore të qytetit, në drejtimin veri-jug dhe është në kuotën më të lartë në krahasim me zonat e tjera të qytetit. Fabrika është e pajisur me filtra për spastrimin e ajrit.

Sipas matjeve të kryera për ndjekjen e nivelit të lëshimit të gazrave të dëmshme për nevojat e SHA Knauf për periudhën 2004-2008, vërehet tendencë e rritjes së sasisë së gazrave të dëmshme të lëshuara për shkak të rritjes së kapacitetit të prodhimit.

Tabela 9. Të dhënat matëse nga Fabrika “Knauf-Radika”-Dibër

Viti	2004	2005	2006	2007	2008
Kapaciteti i relizuar i prodhimit (t.)	123.902	122.577	149.092	162.507	172.000
Numri i përgjithshëm i orëve të punës	6159	6128	7454	7850	8190
Kapaciteti i kaldajës MW	5	5	5	5	5
Periudha e emisionit-kohës në punë (ditë/vit)	260	255	310	328	340
Numri i ditëve dhe orëve të punës në burim	24	24	24	24	24
Konsumi mesatar vjetor i m ³ të gazit natyror.	3620	3450	4028	4908	5200
Konsumi mesatar vjetor i mazutit (t)	2675	2650	3025	3307	3560
Vëllimi i përgjithshëm i gazrave/ sasisë së rrjedhjes (Nm ³ /h)	80765	-	-	103.752	-
Përqëndrimi i SO ₂ (mg/Nm ³)	227	-	-	347	
Përqëndrimi i NO _x (mg/Nm ³)	71	-	-	128	
Përqëndrimi i CO (mg/Nm ³)	16	-	-	33.2	
Përqëndrimi i grimcave të forta	35.5	-	-	34.1	
Zhurma (dB)	51-62 (81-83)	51-62 (81-83)	51-62 (81-83)	51-62 (81-83)	51-62 (81-83)

Gjatë periudhës së lagështisë më të madhe në ajër ndihet një aromë e pakëndshme nga gazrat që i nxjerr kjo fabrikë, gjë që ndikon nëgativisht te popullata në qendrën e banuar që kufizohet me fabrikën. Fabrika ka paraqitur kërkesë për lëshimin e lejes së integruar- B.



Fotografia 5 Fabrika “Knauf-Radika”

Komuna e Dibrës nuk ka as kapacitetet njerëzore e as teknike për ndjekjen e pavaraur të cilësisë së ajërimit në ambientin e jetësor. Për çdo rast do të jetë i nevojshëm kontrolli i kohëpaskohshëm i cilësisë, veçanërisht gjatë periudhave kritike (në kushtet e rritjes së

lagështisë në ajër). Për këtë qëllim përveç hartimit të planeve për përmirësimin e cilësisë së ajërit në ambient, komuna planifikon të angazhojë firma të jashtme të akredituara që do të bënin matjen e cilësisë së ajrit disa herë gjatë vitit.

3.2 Ndotja e ajërit nga burime mobile dhe stacionare

Trafiku paraqet burim dinamik të linjave për ndotjen që shtrihet përgjatë rrugëve të ngarkuara me trafik në qytet, rrugëve magjistrale si dhe nga mbingarkesa e përqëndruar në pikat e udhëkryqeve më të mëdha. Sipas të dhënave që disponojmë numri i automjeteve motorike shënon tendencë të rritjes së vazhdueshme, ndërsa e njëjta gjë vlen edhe për konsumin e karburanteve.

Tabela 10. Numri i automjeteve për udhëtarë dhe mallra

	Auto. për udhëtarë	Auto. për mallra
2002	1552	142
2003	1597	140
2005	1720	120
2006	1771	123
2007	1824	131
2008	1875	139

Tabela 11. Karburante të shitura në pompat e benzinës në Dibër

Lloji i karburantit	Litra për 2005	Litra për 2007
Bio-Dizel	1.757.800	2.163.000
Benzin pa plumb	625.400	720.000
Eko Super 98	420.800	632.000
Auto gaz	142.000	510.000

Si rezultat i angazhimit të legjislacionit për cilësinë e karburanteve, përmbajtja e lëndëve të rrezikshme dhe të dëmshme, viteve të fundit është zvogluar, kështu që konsumi i rritur i karburanteve nuk ndikon në masë të madhe në ndotjen e ajërit.

Sipas të dhënave në Dibër në 1000 banorë ka 95 automjete udhëtarësh, që në krahasim me qytetet e vendeve më të zhvilluara, ku numri i automjeteve në 1000 banorë lëviz ndërmjet 500-600, ky numër është i vogël.

Dibra në mënyrë solide është e mbuluar me rrjetin rrugor. Në qytet nuk është organizuar transporti publik, qyteti i Dibrës nuk ka rrugë qarkore për trafikun transit, kështu që trafiku zhvillohet nëpër qendrat urbane, gjë që paraqet problem si në aspektin e sigurisë në trafik ashtu edhe në aspektin e paraqitjes së zhurmës, si edhe në aspektin e lëshimit të gazrave në ajër. Rrugët më të ngarkuara në trafikun transit janë të evidentuara, Rr "8 shtatori", "Vllazërim Bashkim", "Hamdi Lleshi", "Velko Vllahoviq" dhe "22 dhjetori". Pikë nevralgjike në trafikun në qytet paraqesin Rruga "Hamdi Lleshi" dhe Rruga "22 dhjetori", të cilat njëkohësisht janë si rrugë rajonale, përkatësisht magjistrale në drejtim të vendkalimit kufitar Bllatë. Këto rrugë janë shumë të ngushta dhe pa trotuarë për këmbësorët, përkatësisht nuk i përmbushin karakteristikat themelore teknike për zhvillimin e këtij lloji të trafikut.

Me hapjen dhe ndërtimin e Bulevardit 100, trafiku i automjeteve të mallrave është riorientuar nga qendra e qytetit drejt këtij bulevardi. Megjithatë qendra e qytetit mbetet e

mbingarkuar me numrin më të madh të funksioneve dhe me dendësinë e banimit, kështu që dendësia e trafikut në këto pjesë mund të kontribuojë në rritjen e përqendrimit të materieve ndotëse, veçanërisht në kushtet e pavolitshme hidrometeorologjike.



Fotografia 6. Bulevardi i ndërtuar i ri "100"

Gjatë periudhës së dimrit afër 90 % e popullsisë shfrytëzojnë nxemjen me dru , gjë që shkakton një vëllim më të vogël të ndotjes së ajërit edhe nëpërmjet lëshimit të gazrave nga djegia e druve për ngrohje.

Sipas analizës së të dhënave të përgjithshme mund të vlerësojmë se përqindja e ajërit të ndotur është në kufijtë e lejuar dhe nuk ndikon në mënyrë serioze në shëndetin e njeriut dhe në biodiversitetin.

Rezume për gjendjen dhe problemet në lëmin tematik AJËRI:

- Nuk ekzistojnë stacione monitorimi të vendsura në territorin e Komunës së Dibrës për ndjekjen e lëshimit të materieve ndotëse në ajër.

-Mungojnë planet dhe programet për zvogëlimin e ndotjes së ajërit.

-Nuk ekziston zgjidhje adekuate e trafikut nëpërmjet një rruge qarkore për trafikun transit dhe riorientimin e tij nga zona qendrore e qytetit.

5. LËMIA TEMATIKE-TOKA DHE SHFRYTËZIMI I TRUALLIT

Toka dhe trualli janë resurse të rëndësishme natyrore dhe ekonomike, veçanërisht për sektorët e bujqësisë dhe pylltarisë, industrisë dhe zhvillimit të infrastrukturës. Kanasje kryesore për gjendjen e mirë të tokës janë kontaminimet lokale dhe difuzive (si rezultat i mosshfrytëzimit të prodhimeve agrokimike), degradimi fizik-mekanik (si rezultat i shfrytëzimit të lëndëve të para minerale) të cilat shkaktojnë transformimin e tokës produktive në tokë joproduktive.



Fotografia7. Panorama e qytetit të Dibrës

4.1 Bujqësia dhe blegtoaria

Komuna e Dibrës sipas të dhënave nga regjistrimi i vitit 2007 disponon me sipërfaqe bujqësore prej 2286 ha, prej të cilave 90 % janë në pronësi private dhe 10% në pronësi shtetërore. Nga sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore si tokë e punueshme, bahçe dhe kopshte shtëpiake ka 1607 ha, livadhe 438 ha, kullota 213 ha, pemë frutore 23.6 ha dhe vrrështa 4 ha.

Nga sipërfaqet bujqësore tokë e punueshme, bahçe dhe kopshte shtëpiake me kultura të bimëve të drithërave janë përfshirë 560 ha, prej të cilave 253 ha grurë, 198 ha misër dhe 109 ha elb. Me bimë foragjere janë përfshirë 1002 ha, nga të cilat dominojnë jonxha me 936 ha dhe tërfoja me 47 ha. Me perime janë përfshirë 32 ha, ku dominojnë fasulja me 9.2 ha, shalqini me 4.8 ha, domatet me 3.96 ha, specat me 3.3 ha, qepa me 3.1 ha, patatja 2.5 ha, trangujt 1 ha.

Dibra në vitin 1993 kishte 3514 ha tokë bujqësore të punueshme, ndërsa në vitin 2008 sipërfaqja është zvogëluar në 2804 ha. Zvogëlimi i sipërfaqeve të punueshme është si rezultat i mosfunksionimit të sistemit SHM të Fushës së Dibrës, dëmtimit të objekteve dhe të rrjetit, arkëtimit jo të rregullt për kompensimin e ujit dhe të funksionimit joadekuat të Bashkësisë së Ujërave.

Problemi i mirëmbajtjes së sistemit për ujitje vështirësohet në mënyrë plotësuese, për

shkak të çmimeve të larta të materialeve riprodhuese të naftës, plehrave, pasigurisë në treg dhe të politikës joadekuate për zhvillimin e bujqësisë.

Lidhur me trajtimin e plehrave dhe të preparateve për mbrojtjen e bimëve 665 ha e tokës trajtohen me plehra minerare, duke përdorur deri në 900 kg dhe deri në 274 ha me plehra organikë. Me preparatet për mbrojtjen të bimëve pesticide dhe insekticide trajtohen sipërfaqe prej 99 ha me përdorim mesatar deri 300 kg (ose 3.03 kg/ha në vit). Krahasur me të dhënat për shfrytëzimin e pesticideve në komunat e tjera (për shembull Resnja shfrytëzon 10 kg/ha/vit), Komuna e Dibrës është në suazat e mesataes së për përdorimin e këtyre preparateve. Edhe në vendet evropiane mesatarja e përdorimit të pesticideve leviz prej 2.5-3.3 kg /ha/vit. Edhe pse përdorimi i mjeteve agrokimike jep efekte më të mira ekonomike, nga ana tjetër përdorimi i tyre i tepruar ka efekte negative afatgjata për ambientin jetësor.

Aplikimi i preparateve kimike në procesin e prodhimit bujqësor, në transmetimin dhe deponimin e materieve helumese, ndikojnë në përbërjen kimike të tokës. Ndryshimi i përbërjes kimike ndikon në mënyrë negative edhe ndaj vlerave të saj ekologjike por edhe ekonomike. Ky lloj i ndotjes reflektohet ndaj cilësisë dhe produktivitetit të tokës, cilësisë dhe sasisë së prodhimit dhe në mënyrë indirekte ndaj cilësisë së ujërave dhe ajërit.

Aktualisht mund të konstatojmë se në Komunën Dibrë përdorimi i preparateve agrokimike nuk ndikon në masë më të madhe në cilësinë e tokës në këtë komunë. Mungesa e një baze adekuate e të dhënave për shfrytëzimin e këtyre mjeteve si edhe për ndjekjen e ndryshimeve në cilësinë e tokës janë problem i përgjithshëm si në nivel lokal ashtu edhe nacional.

Në territorin e komunës Dibrë nuk ka ferma të mëdha të gjedhëve. Numri i përgjithshëm i lopëve arin 1.400 kokë. Sipas të dhënave që janë në dispozicion në Komunën e Dibrës ka afër 20.000 dele. Blegtoria është mjaft e përhapur për shkak së komuna është e njohur për nga sipërfaqet e mëdha të kulturave foragjere dhe të hapësirave të mëdha të kullotave malore në afërsi të drejtpërdrejt me komunën. Në të kaluarën blegtoria ishte më shumë më tepër e zhvilluar, ndërsa tani kultivohen bagëtitë në pjesën më të madhe për nevojat vetjake.

4.2 Shfrytëzimi i truallit

Për qytetin e Dibrës në vitin 2004 është nxjerrë Plani Gjeneral Urbanistik me të cilin janë përfshirë sipërfaqe prej 415 ha. Me planet detale urbanistike është mbuluar 60 % e territorit e përfshirë me PDU. Vendbanimet e tjera nuk janë mbuluar me plane urbanistike dhe për këto vendbanime është nxjerrë akti i përgjithshëm për kushtet dhe mënyrën e ndërtimit në vendbanime. 70 % e planeve detale urbanistike të qytetit janë të vjetra dhe jocilësore.

Si rezultat i gjendjes joadekuate të rregullimit planësor e hapësinor, të funksionimit joadekuat të shërbimit të inspektimit në periudhën e kaluar dhe të ndikimeve sociale-ekonomike, është regjistruar dukuria e një numri të madh të ndërtimeve pa leje. Për këtë arsye në mënyrë të pakontrolluar dhe pa plan është uzurpuar me ndërtime toka bujqësore dhe trualli tjetër i pandërtuar. Si pasojë e kësaj paraqiten edhe problemet e infrastrukturës joadekuate dhe problemet për përfshirjen e ardhshme të tyre në planet urbanistike, gjë që nga ana tjetër ndikon negativisht edhe ndaj cilësisë së jetës së qytetarëve.

Ndërtimi pa leje është dukuri që vërehet si në qytet ashtu edhe në vendbanimet e tjera. Deri në vitin 2005 shërbimi për dhënien e lejeve për ndërtim dhe shërbimi i inspektimit nuk ishin në kompetencë të komunës, gjë që në mënyrë plotësuese e ndërlikon gjendjen e tanishme.

Me industrinë dhe ekonominë e vogël është përfshirë sipërfaqe prej 33 ha, ndërsa me

PGU parashikohet që sipërfaqja për industri dhe ekonomi të vogël të zgjerohet deri në 51 ha. Kjo don të thotë që deri në vitin 2014 parashikohet rritje e sipërfaqes për 18 ha të destinuar për industri. Duke u nisur nga tendenca për realizimin e planit urbanistik dhe të kushteve tjera ekonomike nuk pritet ndërtim i objekteve më të mëdha industriale.

20 vitet e fundit karakterizohen nga migrimi masovik i popullsisë në relacionin fshat-qytet. Për shkak të zhvillimit të pakontrolluar urbanistik janë ndërtuar qendra të tëra banimi, sië është Kojnara e Re me rreth 40 ha, Taraniku me rreth 15 ha dhe pjesë tjera më të vogla në periferinë e qytetit të Dibrës. Problemi me përfshirjen dhe uzurpimin e truallit me ndërtimin e objekteve individuale të banimit është më i shprehur në vendbanimet Kosovrast i Poshtëm dhe Mogorçë, ku vërehet rritje e popullsisë, ndërsa në fshatrat e tjera kjo dukuri është gati e pa vërejtur. Për parandalimin e kësaj tendence të zhvillimit të pakontrolluar urbanistik komuna është e detyruar të ndërmerr masa për ndalimin e kësaj dukurie nëpërmjet nxjerrjes së planeve urbanistike, me të cilat në mënyrë minimale do të përfshihen sipërfaqet bujqësore dhe në të njëjtën kohë do të kryhet edhe kontrolli më rigoroz ndaj përhapjes së ndërtimeve pa leje.

Vendbanimet Sollokiç (Shullan), Ame dhe Banisht shënojnë zvogëlim të banorëve për shkak të shpërnguljes masive në qytet.

Është regjistruar dukuria e ndërtimit të ndërtesave individuale të banimit dhe të kapaciteteve për ekonominë e vogël që ndërtohen në sipërfaqet bujqësore të cilat janë të përfshira me sistemin e ujitjes SHM fusha e Dibrës.

Sa i takon përfshirjes së sipërfaqeve bujqësore me rrugë dhe rrugica, aktualisht problemi nuk paraqitet i madh. Viteve të fundit nuk janë hapur rrugë të reja nëpër sipërfaqet bujqësore. Në suazat e përfshirjes urbanistike me PGJU-n të ri është parashikuar unaza rreth qytetit me qëllim të evitimit të trafikut transit nga qendra e vendbanimit të qytetit.



Degradimi i truallit shkaktohet edhe si rezultat i shfrytëzimit të gjipsit-rreth 200.000 t/vit në sipërfaqe prej 1 ha. Zonat e pambrojtura erozive janë regjistruar në f.Kosovrast i Poshtëm, në sipërfaqe prej 2 ha me çka zvogëlohet sipërfaqja për shfrytëzimin e truallit. Ndikim të madh në degradimin e truallit në komunë ka edhe shfrytëzimi i rërës në sipërfaqe prej 2 ha.

Fotografia :Trualli i degraduar nga shfrytëzimi i palejueshëm i rërës

Është konstatim i përgjithshëm se toka nuk është e ndotur në masë të madhe. Në territorin e Komunës së Dibrës nuk ka kapacitete të mëdha industriale të industrisë së rëndë që do të ndikojnë në ndotjen e tokës.

Rezyme për gjendjet dhe problemet në lëmin tematik TOKA DHE SHFRYTËZIMI I TRUALLIT

- Përfshirja e truallit nga zhvillimi i pakontrolluar urban si rezultat i ndërtimit pa leje dhe i planifikimit joadekuat urbanistik.
- Nuk ekziston baza e të dhënave për shfrytëzimin e preparateve agrokimike në bujqësi dhe ndikimi i tyre në cilësinë e tokës.
- Degradimi i truallit nga shfrytëzimi pa leje i rërës në hapësirën e bregut të Liqenit të Dibrës në sipërfaqe prej 2 ha.
- Degradimi i truallit nga erozioni në f.Kosovrast i Poshtëm në sipërfaqe prej 2 ha
- Shfrytëzimi i pamjaftueshëm për prodhimin e EKO prodhimeve;
- Sistemi jofunksional për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore.

5.1 LËMAI TEMATIKE- NATYRA

Territori i Komunës së Dibrës përbëhet nga Fusha e Dibrës, shpatijeve të malit Kërçin (Deshat), Liqenit të Dibrës dhe luginës së Lumit Drini i Zi. Qyteti i Dibrës ndodhet në lartësi mbidetare 630-700m. Hapësira e Komunës së Dibrës ka një pozitë të atillë, ku bashkohen dy lugina të rëndësishme pitoreske kanjonike nëpër rrjedhën e lumenjve Radikë dhe Drini i Zi.

5.1.PYLLTARIA

Në territorin e përgjithshëm të komunës pyjet përfshijnë sipërfaqe prej 10.953 ha. Nga llojet e pyjeve më të përfshira janë ahë 81%, dushku 8%, pisha e zezë 5%, bredhi 5% dhe 1 % të tjera.

Shfrytëzimi i pyjeve nga banorët kryesisht përdoret për ngrohje, sepse 90 % e banorëve të komunës ngrohen me dru, kurse nuk është i vogël numri edhe i druve që shfrytëzohet për industrinë e drurit.

Në f.Kojnarë dhe në rrethinën e saj ka sasi të madhe të drurit të gështenjës (*castanea sativa*) dhe në nivel vjetor grumbullohen ose mblidhen deri në 150t gështenja.



Pylli me dru ahu në Jamë



pylli i dëmtuar nga prerja pa leje

Prerja e planifikuar vjetore arrin 9.100 m³ dru për djegie dhe 500 m³ dru teknik. Kanosje serioze për pyjet është dukuria e prerjes pa leje, gjë për të cilën nuk mbahet evidencë, ndërsa vetë ekonomia pyjore nuk ka numër të mjaftueshëm kuadrosht të cilët do ta ushtronin kontrollin e vazhdueshëm në terren.

Tabela12 :Numri i regjistruar i zjarreve, sipërfaqet e përfshira nga zjarri dhe dëmi ndaj masës drusore në periudhën 1998-2007

Viti	numri i zjarreve	sipërfaqe	masa drusore
1998	0	0	0
1999	0	0	0
2000	6	59	627
2001	2	9	650
2002	5	6	95
2003	4	18	53
2004	1	3	15
2005	0	0	0
2006	0	0	0
2007	8	118	590

Shkaqet e paraqitjes së zjarrit:

1. Thatësitrat për një periudhë të gjatë dhe temperaturat e larta ekstreme;
2. Paraqitja e rrufeve;
3. Faktori njeri-dalja në pikniqe, dalja në kampim, gjuetarët, barinjtë;
4. Shkaqe të papërcaktuara.

Shkaku më i shpeshtë për paraqitjen e zjarreve është faktori njeri, ndërsa motivet janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga mosintersimi dhe pakujdesia deri te realizimi i përfitimit personal për zgjerimin e kufijve të parcelave të punueshme, livadheve ose kullosave, ose shprehja e pakënaqësive ndaj institucioneve të sistemit.

Çdo vit NP Pyjet e Maqedonisë, OP Stogovë –Dibër, në mënyrë programore kryejnë

mbjellejen e fidaneve (pyllëzimin).

Tabela 13. Pyllëzimi-NP Pyjet Maqedonisë, OP Stogovë-Dibër

Viti	Lloji i fidaneve për he		
	Pisha e zezë	Bredhi	Çami
2002	10 he (25.000 fid.)	5he (12.500 fid.)	5 he (farë çami 30kg)
2003	10 he (25.000 fid.)	5he (12.500 fid.)	5 he (farë çami 30kg)
2004	8 he (20.000 fid.)	7he (12.500 fid.)	7he (farë çami 50kg)
2005	8 he (20.000 fid.)	7he (12.500 fid.)	7he (farë çami 50kg)
2006	9 he (22.500 fid.)	6he (15.000 fid.)	6he (farë çami 40kg)
2007	11 he(27.5000 fid.)	5he (12.500 fid.)	6he (farë çami 40kg)

Problemi që paraqitet te fidanet e reja është përqindja e vogël prej 5% e suksesit të mbjelljes, si rezultat i dëmtimit të tyre nga kullotja e bagëtisë dhe nga mbrojtja dhe kultivimi joadekuat i fidaneve të reja.

Sëmundjet e pyjeve gjithashtu janë shkaktarë për zvoglimin e fondit të pyjeve. Sëmundjet etimologjike i përfshijnë kulturat e pishave, ndërsa dëmtuesit më të pranishëm janë: turigjati i pishës, çetniku i pishës dhe dispari (Lymantria dispar) i pishës. Kulturën e dushkut më shpesh e sulmon flutura turinjgjatë. Nga shkaktarët fito-patologjikë të sëmundjeve është e pranishme të kalburit e palcës së rrënjës që e shkakton këpurdha (armilia merlea), në të njëjtën kohë ka paraqitje edhe të hirit në gjethin e dushkut (microchaera alfitoides). Përhapja e sëmundjeve sipas sipërfaqeve dhe sipas viteve arrin 2003- 2 ha, 2004- 1ha, 2005- 2ha, 2006- 1.5 ha dhe 2007- 2ha. Meqëse bëhet fjalë për sipërfaqe të vogla të dëmtuara sipas nevojës kryhet edhe djegia e organizuar e çerdheve të këtyre dëmtuesve, posaçërisht e disparit. Deritani nuk ka patur nevojë për spërkatjen e sipërfaqeve të mëdha të pyjeve.

5.2 Lëndët e para minerale

Në territorin e Komunës së Dibrës ndodhet reliefi i vetëm i gjipsit në Republikë, i cili shtrihet në gjatësi prej 9 km. Minerari i gjipsit është i një cilësi të lartë, me përmbajtje prej 99 % gjips të pastër, gjë që për nga cilësia zen ndër vendet e para në botë.

Në lokalitetin e njohur si gjipsara e vjetër, rreth 4 km në lindje të Dibrës në afërsi të fshatit Rajçicë ndodhet shpella e quajtur Allçia. Shpella paraqet pjesë të rezervës së madhe të gjipsit, përkatësisht vendburim i mbushur me gjips kristal. Kristalet janë të tejdukshme qartazi me mundësi copëtimi në dy drejtime dhe me madhësi të dukshme, gjë që i jep bukuri dhe veçori të jashtëzakonshme edhe në suaza evropiane.

Sipas Planit Hapësinor të RM, studimi i sektorit për mbrojtjen e trashigimisë natyrore, shpella Allçia është propozuar që të shpallet si zonë e mbrojtur në kategorinë e monumenteve të natyrës.

Shpella ka rëndësi shkencore, kërkimore, edukative dhe turistike. Mirëpo, si rezultat i shfrytëzimit të pakontrolluar të gjipsit kristal nga kjo shpellë nga koncioneri “Knauf-Radika”, kjo shpellë objektivist është e rrezikuar si gjeolokalitet. Për këto shkaqe, komuna planifikon të ndërmer hapa të shpejtë me qëllim të intensifikimit të bisedimeve me ministrinë kompetente që sa më parë kjo shpellë të shpallet zonë e mbrojtur.

Burimet gjeotermale

Në luginën e Dibrës në sipërfaqe prej 8 km² është regjistruar fusha gjeotermale, ndërsa thellësia e kolektorit është 200 m, kurse temperatura arrin 50 C. Nga kjo fushë burojnë 2 burime termominerale në fshatrat Kosovrast dhe Banisht (të dhënat nga shekulli i 13-të). Në fshat Kosovrast I Poshtëm është regjistruar rrjedhje sipërfaqësore me temperaturë 48 C dhe prurrje prej 60 l në sekondë. Në fshatin Banisht temperatura e ujit është 38 C dhe prurrja prej 40 litra në sekondë. Në këto lokalitete janë ndërtuar dy banja mjekuese Banishti dhe Kosovrasti të njohura ndërkombëtarisht.

Ky resurs natyror energjetik jep mundësinë për prodhimin e energjisë ngrohëse, e cila mund të përdoret në bujqësi dhe blegtori.



Foto Banja në Banisht



Foto Banja në Kosovrast

5.4 Gjuetia dhe peshkimi

Liçeni i Dibrës ndodhet në pjesën përfundimtare perëndimore të Republikës së Maqedonisë i vendosur në pjesën më të ulët të luginave të lumit Drini i Zi dhe të lumit Radikë, në fund të luginës së Dibrës, të rrethuar nga malet Jabllanicë, Stogovë dhe Kërçin (Deshat).

Liçeni i Dibrës furnizohet me ujërat e lumenjve Drini i Zi dhe Radikë, me ujërat në sipërfaqen e drejtpërdrejt të derdhjes, me ujërat nëntokësore, burimet dhe të reshurat që derdhen në liçe.

Linja e bregut të liçenit të Dibrës është me një numër më të madh të gjirave më të vegjël dhe më të mëdhej, me konfiguracion të larmishëm në fundin e tyre, me përbërje heterogjene të botës shtazore dhe bimore që reflektohet edhe ndaj fondit të peshqve,

Liçeni i Dibrës bën pjesë në akumulimet me produktivitet peshku nga mesatarja deri në nivelin e lartë që arrin 50 kg/ha. Strukturën e tanishme të llojeve të fondit të peshqve e përbëjnë trofta, krap, bërcaku, shkoballi, mrena, trembëllaku, njala etj.

Deri në vitin 2005 koncensioneri i liçenit HC "Spile" -Dibër kryente gjuetinë ekonomike të peshkut me rrjeta, njëkohësisht jepte edhe leje për peshkim sportiv. Në këtë periudhë vlerësohet se gjuetia vjetore arrinte 15.000 deri 20.000 kg peshk.

Nga viti 2005 koncensioneri për peshkim në Liçenin e Dibrës si edhe në një pjesë të lumit Radikë është Shoqata e peshkimit sportiv "Trofta" dhe Shoqata Ekologjike "Deshat". Koncensionerët e rinj, në interes të përmisimit të gjendjes së peshkimit të pa kontrolluar, në mënyrë rigorozë e ka ndaluar gjuajtjen e peshkut me rrjeta.

Për peshkimin sportiv mesatarisht lëshohen 150 leje vjetore dhe 800 leje ditore. Çdo vit kryhet shtimi i fondit të peshkut me këlyshë peshku, kryesisht me troftë, krap dhe njala, të

furnizuara nga institucionet e autorizuar, fermat për shumimin dhe rritjen e peshkut në Maqedoni.

Tabela 14. Shtimi i peshqve

Viti	Lloji i peshkut	Sasia (copë)
2006	Troftë-këlysh (nga ohri)	10.000
2006	Njala	500
2007	Troftë-këlysh (nga ohri)	8.000
2007	Njala	500
2008	Krap-këlysh	40.000
2008	Njala	500



Trofta e Radikës (Salmo Montenegritis)

Lloji më i rrezikuar i peshkut është trofta autoktone e Radikës, e cila është më cilësore dhe në të njejtën kohë më e ndijshme. Përveç gjuajtjes pa leje ky lloj peshku është rrezikuar edhe për shkak të ndotjes së Liqenit të Dibrës si rezultat i funksionimit joadekuat të stacionit të spastrimit Vranishtë (në rajonin të Ohrit-të Strugës). Shpeshherë për shkak të faturave të pa arkëtuara për energjinë elektrike, stacioni i spastrimit nuk funksionon dhe ujërat e zeza derdhen drejtpërdrejt në lumin Drini i Zi.

Në kuadër të Komunës së Dibrës gjuetia është e organizuar nëpërmjet Shoqatës së gjuetarëve Stogovë-2, e cila është koncensionere e tre rajoneve për gjueti: Stogova, me sipërfaqe prej 16.406 ha, Deshati, me sipërfaqe prej 3.430 ha dhe Bohmova me 3.410 ha. Në vendet për gjueti nuk janë ndërtuar objekte për vendosjen e gjuetarëve. Në 5 vitet e fundit mesatarisht në nivel vjetor janë regjistruar 150 deri 200 gjuetarë (kryesisht banorë lokalë). Kohëve të fundit për gjueti kanë shfaqur interes edhe shtetasit e huaj nga Greqia dhe Italia kështu që në vitin 2007 janë regjistruar 7, kurse në 2008 14 gjuetarë të huaj.

Nga mbikëqyrjet që janë kryer gjatë vitit 2007 nga ana e rojtarëve të gjuetisë dhe antarëve të shoqatës së gjuetarëve, në tabelën vijuese është pasqyruar numri i llojeve të kafshëve të egra të regjistruara në ditën e numrimit pranveror për vitin 2007 dhe numri në ditën e numrimit vjeshtor për vitin 2008.

Tabela 15. Numri i llojit të shtazëve të egra të regjistruara

Lloji i shtazëve të egra	Numri në ditën e numrimit pranveror 2007	Numri në ditën e numrimit vjeshtor 2008
Derri i egër	26	27
Ariu	-	13
Kaprolli	32	30
Lepuri	35	36
Macja e egër	5	5
Ujku	7	6

Ruqerbulli	2	4
Thëllëza e malit	20	22
Dhelpra	9	6
Thëllëza e fushës	11	2



Fotografi e Lluqerbullit lloj i mbrojtur në mënyrë rigoroze

Në vendin për gjueti janë angazhuar 1 roje e gjuetisë i paguar dhe 2 roje vullnetare. Gjuetia është e lejuar gjatë kohës së vikendeve dhe festive. Më shpesh gjuhen lepuri dhe derri i egër, dhelpra ndërsa më rrallë edhe ujku. Në mënyrë rigoroze është ndaluar gjuetia e llojeve të rralla të kafshëve të egra siç janë ariu, ruqerbulli, dhia e egër dhe shqiponja. Për kujdesin, përkatësisht ushqimin e kafshëve të egra në kushte të pavoritshme dimërore, janë caktuar lokalitete ku bëhet furnizimi me ushqime. Në vitin 2007 janë shpërndarë tre tonelata ushqim, ndërsa në vitin 2008 katër tonelata ushqim (patate, mollë, elb, koncentrat panxhari, kripë etj.)

Tabela vijuese pasqyron numrin e kafshëve të egra të gjuajtura në territorin e vendeve për gjueti.

Tabela 16. Numri i kafshëve të egra të gjuajtura

Viti	Numri i lejeve të lëshuara	Numri i shtazëve të egra të gjuajtura sipas llojeve			
		Derri i egër	Lepuri i egër	Ujku	Dhelpra
2004	135	41	32	-	18
2005	126	32	41	2	28
2006	172	52	34	3	32
2007	155	48	38	2	28
2008	140	38	29	0	24

Për shkak të ekzistimit të gjuetisë jolegale për cilin do lloj të kafshëve të egra, rrezikohen lloje të caktuara të kafshëve të egra të rralla siç janë: kaprolli, dhia e egër dhe ariu. Gjuetia jolegale shpeshherë kryhet me mjete të palejuara-tela çeliku dhe gjuetia gjatë natës. Kjo dukuri është e regjistruar në vendin e gjuetisë Bohmovë që ndodhet në zonën kufitare të Republikës së Maqedonisë me Republikën e Shqipërisë. Shpeshherë në kurthet e vendosura janë kapur


edhe ari si shtazë të egra të mbrojtura në mënyrë rigoroze. Konkensioneri nuk disponon të dhëna për numrin e kafshëve të egra të gjuajtura në mënyrë jolegale, nuk ka as edhe kapacitetin që të ballafaqohet me këtë problem. Për këtë arsye planifikohet të vendoset bashkëpunim i ngushtë me pushtetin vendor, policinë kufitare si edhe të formalizohet bashkëpunimi ndërkufitar me strukturat përkatëse nga Republika e Shqipërisë.

Në Rajonin e Dibrës rritet një numër i madh i bimëve mjekuese, para së gjithash i bimëve mjekuese të gjelbërta me kërcyll të ulët. Mbledhja kryhet në mënyrë të paorganizuar dhe joadekuate. Shpeshherë mbledhësit e këtyre bimëve në mënyrë joprofesionale dhe të pakujdesshme i mbledhin këto bimë duke i nxjerrë me gjithë rrënjët, gjë që e zvogëlon mundësinë e përtritjes së këtyre bimëve. Në komunë nuk ekziston qendër për grumbullimin e bimëve mjekuese, ose të paktën për grumbullimin e këpurdhave dhe të kërmillit, nuk mbahet asfarë evidence për bimët e mbledhura dhe as nuk ekziston institucion kompetent që do ta ushtronte kontrollin në terren.

5.5 Turizmi

Faktorët natyror dhe përparsitë shekullore të ndërtimeve të lashta , tradita dhe zakonet e rajonit të Dibrës janë të llojllojshme dhe të dëshmuara. Burimet termominerale dhe mjekuese janë bazë për zhvillimin e turizmit banjor. Vizitorët e këtyre banjave shërbimet turisitike i marrin në objektet hotelierike të vendosura përbri vetë burimeve në fshatin Banisht dhe në fshatin Kosovrast dhe në hotelin Venec (Uraniku) i vendosur në qytetin e Dibrës. Kapaciteti i përgjithshëm i strehimit arrin 700 shtretër me më shumë se 150 të punësuar. Mesatarisht në vit realizohen 50.000 deri 70.000 buajtje. Kapacitetet e strehimit nëpër shtëpitë individuale nuk janë evidentuar.

Liçeni i Dibrës, malet dhe kushtet e tjera natyrore paraqesin potencial të shkëlqyer për zhvillimin e turizmit liçenor-sportiv rekreativ. Gjatë periudhës së verës, plazhi i Liçenit të Dibrës tërheq edhe deri në 2000 vizitorë në ditë. Në pjesën e bregut në plazh nuk janë zhvilluar objekte infrastrukturore dhe nuk janë ndërtuar kapacitete hotelierike dhe rekreative përkatëse. Në këto pjesë janë ndërtuar 6 objekte të përkohshme të cilat nuk ofrojnë shërbime cilësore në drejtim të zhvillimit të vërtetë të turizmit liçenor.



Plazhi në Liçenin e Dibrës

Në vitin 2005 filloi të funksionojë objekti i rikonstruktuar i Klubit për kajak dhe kanu i shndëruar si qendër për zhvillimin e turizmit liçenor sportiv dhe rekreativ. Këtu organizohen

regata shtetërore dhe ndërkombëtare për kajak në ujëra të qeta, me çka tërhiqen vizitorë nga jashtë dhe nga vëndi. Nga viti 2005 vërehet numër i shtuar i turistëve gjatë vikendit të insteresuar për peshkim.

Problem paraqet fakti që hotelet dhe kapacitetet e tjera nuk kanë satcione spastrimi dhe ndodhen përbri liqenit të Dibrës dhe rrjedhjeve të lumenjve.

Rezyme për gjendjen dhe problemet në lëmin tematik NATYRA:

Sipas të dhënave të arritura nga vlerësimi i kryer për gjendjen e mjedisit jetësor në lëmin tematik NATYRA janë paraqitur disa probleme

1. Prerja jolegale dhe shkatërrimi i pyjeve;
2. Rrezikimi i kafshëve të egra të rralla (kaprolli,shqiponja) nga gjuetia jolegale;
3. Mosshfrytëzimi i resurseve natyrore për zhvillimin e ekoturizmit;
4. Infrastruktura e pazhvilluar në bregun e Liqenit të Dibrës dhe në lokacionet për pikniqe;
5. Peshkimi jolegal.

ANKETIM PUBLIK

Hulumtimi i opinionit publik të qytetarëve për problemet me mjedisin jetësor në teritorin e komunës së Dibrës

1. Hyrje

Në përputhshmëri me metodologjinë për përpunimin e planit Lokal akcional për veprim në mjedis (PLVM), në vargjen e aktiviteteve të cilat duhet të ndërmerren për realizimin e suksesshëm të këtij dokumenti i cili përgaditet për nevojat e Komunave, është e nevojshme të përcaktohen problemet prioritare për zgjidhjen e problemeve në lidhje me mjedisin jetësor..

Në ecurinë e identifikimit të problemeve prioritare në lidhje me mjedisin,veçanërisht është me rëndësi të merret parasysh opinionit publik (mendimi i qytetarëve dhe i të gjithë pjesëmarrësve bashkësinë lokale).

Për hulumtimin e opinionit publik që realizuar Anketim nga ana e komitetit Lokal (Grupi punues për hulumtimin e opinionit publik)e paraqitur në formë të fletës anketuese.Sipas një selektimi të thjeshtë të solucioneve të ofruara në fletën anketuese, qytetarët i parrashtronin problemet e mjedisit që i rrethon,me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë.

Nëpërmjet këtij hulumtimi u vërtetua opinionit i banorëve të Komunës së Dibrës në lidhje me gjendjen mjedisit jetësor, për çdo domen në veçanti (uji,ajri,mbeturinat,tokat dhe ndotja e dheut dhe natyrës), gjatë asaj u konstatuan problemet me prioritet të lartë për tu zgjidhur.

2. Qëllimi kryesor

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ishte realizimi i anketimit, për hulumtimin e opinionit publik.Ajo që ndërlidhur me nevojën ,banorët e qytetit të Komunës të Dibrës të japin mendimin e tyre për problemet me të cilat zakonisht ballafaqohen në komunën e tyre ,dhe që i takojnë mjedisit jetësor.

Anketa publike u realizua si pjesë përbërëse e vazhdës të aktiviteteve ,të nevojshme për realizimin e suksesshëm të PLVM -ës,dokument i cili është në punim e sipër.

Nëpërmjet anketimit,banorët e gjithë teritorit të komunës duke mbushur fletët anketuese,i parashtronin problemet,që në përputhshmëri me shkallën e tyre të përkujdesjes,paraqesin prioritet për zgjidhjen e problemit.Më vonë me përpunimin e të dhënave të mbledhura me anketimin,u konstatuan problemet më serioze ne lidhje me mjedisin jetësor(domeneve tematike),të cilat ngjallin kujdes më të madh te banorët e komunës.

Në mes tjerash,konstatimi i problemeve më prioritare që kërkojnë zgjidhje është i rëndësishëm nga aspekti i konstatimit të saktë të qëllimeve,masave dhe akcioneve për zgjidhje të sukseshme të problemeve.

3. Metodologjia/Qasja

Për hulumtimin e opinionit publik,në përputhshmëri me metodologjinë për përpunimin e dokumentit të PLVM -ës, u përdor metoda e Anketimit.

Anketimi u realizua në muajin janar të vitit 2009, i njëjti përfshiu shpërndarje të fletëve me listë të solucioneve të ofruara(probleme me mjedisin jetësor), me të cilën përzgjedhje të anketuarit i mbushnin fletët anketuese.Komuna e Dibrës përgaditi fletë anketuese me gjithsejit 30 (tridhjetë) probleme të parashtruara, nga të cilat qytetarët duhet të përcaktojnë gjithsejit 10(dhjetë) probleme për të cilat mendojnë se janë prioritare.

Gjithashtu, të anketuarëve ju dha mundësia të paraqesin vërejtje,probleme të cilat nuk qenë të identifikuar në fletën anketuese.

Fletët anketuese u distribuuan nëpër amvisëritë, gjithashtu edhe nëpër institucionet në komunë, (administratën shtetërore,vetqeverisjen lokale,ndërmarjet publike,entet shëndetsore,shkollat,sektorin e biznesit,OJQ-të,etj) Në distribuimin e fletëve anketuese ishin të përfshirë 13 persona, përndryshe anëtarë komitetit Lokal,si dhe: perfaqsesit e OJQ-ve,drejtorët e shkollave,dhe perfaqsesit e bashkësive lokale,ndërsa institucionet arsimore(shkollat) qenë të përfshira në ate mënyrë,ashtu që nxënësit i shpërndanin fletët anketuese nëpër shtëpitë e tyre.Gjithë pjesëmarrësit përgjegjës në zbatimin e anketimit në mënyrë vullnetare u kyçën në realizimin e anketës.

Vende të banuara në Komunën e Dibrës, të cilat u përfshinë në anketim janë këta që vijojnë:qyteti i Dibrës me 14,561 banorë, f.Mogorçë me 1.794 banorë, f.Kosovrasti i Epërm me 818,f.Raçicë-131, f.Banjisht me 90, f.Zepishtë-499 si dhe f.Otishan-530 banorë.(në përputhshmëri me regjistrimin e popullatës të vitit 2002). Me anketimin u përfshi strukturë qytetarësh me profil të ndryshëm arsimor, statusi martesor,moshë dhe gjini.

Me qëllim që të pasqyrohet struktura e vërtetë e popullatës në komunë,në aspektin e përkatësis gjinore,profilin arsimor,statusit dhe moshës (shembull reprezentativ i të anketuarve),u shpërndanë asi numri i fletëve anketuese, në mënyrë që të përfshihen më tepër se 5% e popullatës së përgjithshme në komunë.Në ate drejtim u shpërndanë 1500 fletë anketuese,që përgjigjet në masën e 7.7% të banorëve në komunë,(Komuna e Dibrës gjithsejt numëron 19,481 banor).

Gjithsesi, pas zbatimit të anketimit,u fillua me përpunimin e të dhënave në pajtim me principet themelore të analizës statistikore.Të dhënat e grumbulluara nga zbatimi i anketës u përpunuan nga grupi Punues për hulumtimin e opinionit publik, përdryshe i formuar nga komiteti Lokal për punimin e dokumentit të PLVM -ës për komunën e Dibrës.

3. Analiza e të dhënave


Statistika e përgjithshme

Nga gjithsejt 14 vende të banuara në komunën e Dibrës,anketimi u zbatua në 8 nga ato.Për arsye se 6 prej vendbanimeve në komunën e Dibrës numërojnë më pak se 20 banorë,komiteti Lokal vendosi që të njëjtat të mos meren parasysh gjatë anketimit.

Nga gjithsejt 1500 fletë anketuese të shpërndara, 350 fare nuk u kthyen, ndërsa 182 ishin të mbushura në mënyrë të parregullt (me rrethim të më pak ose më tepër se 10 problemeve). Nga të dorëzuarat 182 fletë të parregullta , gjatë përpunimit të të dhënave u morën parasysh 137 nga ato (ato fletë anketuese me më pak se 10 probleme të rrethuara).Në fund qenë përpunuar gjithsejt 1,013 fletë anketuese, ose 5.2% nga numri i përgjithshëm i banorëve në komunën e Dibrës. Numri i fletëve të shpërndara për vendbanime duket si vijon: Dibër-1,070, Mogorçë-140, Kosovrasti i P. 85, Kosovrast i Epërm-65, Raçicë-20, Zepishtë-60, Otishan-45 dhe Banjisht-15.


Në grafikun e mëposhtëm janë dhënë rezultatet sipas vendbanimeve (numri i përgjithshëm i të anketuarve sipas vendbanimeve ose numri i përgjithshëm i fletëve të anketimit të mbushura në mënyrë të rregullt),në komunën e Dibrës.

Grafiku 1 –Pasqyra e numrit të përgjithshëm sipas vendbanimeve.



Nga grafiku mund të vërehet se numri i qytetarëve të anketuar sipas vendbanimeve duket si vijon:Në qytetin e Dibrës u anketuan 743 banorë,në f. Mogorçë numri i të anketuarve numëronte 78,në f. Kosovrasti i Poshtëm -53,në fshatrat Kosovrasti i Epërm u anketuan gjithsejt 42 banorë,në f. Otishan -33,f. Rajçicë -12 dhe Banjisht -10 anketues.

Numri i përgjithshëm i të anketuarve sipas mjediseve urbane dhe rurale ,të cilët ishin të përfshirë në anketim,më poshtë është paraqitur me grafik.




Grafiku 2- Numri i të anketuarve në mjediset urbane dhe rurale.

73 % nga gjithsejt qytetarë të anketuar ose gjithsejt ose 743 të anketuar janë banorë janë nga hapsirat e qytetit ndërsa 27%(banorë) nga popullata e anketuar jetojnë në mjediset rurale.

Përpunimi i të dhënave që janë të lidhura me strukturën e vendbanimit


Në vazhdim, me përdorimin e paraqitjes grafike është i dhëtur proporcioni në mes të anketuarve sipas **strukturës gjinore,statusit martesor,arsimit dhe strukturës moshore**, në nivel të qytetit.



Grafiku 3 – Struktura gjinore


Sipas strukturës gjinore.569 të anketuar të cilët morën pjesë në këtë anketim janë burra (56%), ndërsa 444 të anketuar janë nga gjinia femërore

(44%).




Grafiku 3 – Struktura moshore

Sipas strukturës moshore numri i qytetarëve të anketuar në moshë nga 7 deri në 14 vjet arrin 223 ose 22% ,nga 15–18 vjet ,183 ose 18% ,prej 19-25vjet, 119 ose 12% prej 26-40 vjet,205 ose 20 % , prej 41-65 vjet, 265 ose 26%, dhe mbi 65 vjet 18 ose 2% nga të anketuarit.



Grafiku 5 – Statuti social i të anketuarve

Nga aspekti i statutit social të qytetarëve të anketuar ,numri i të anketuarëve të punësuar është 462 ose 46% , ndërsa 551 ose (54%) i të anketuarve u deklaruan si të papunë



Grafiku 6 – Struktura arsimore

Numri i qytetarëve të anketuar me arsim të mesëm në raport me të tjerët arrin 406 (40%), me arsim fillor janë të anketuar 305 (30%) të qytetarëve. Kurse me arsim të lartë janë anketuar 294 ose (29%) dhe 1% (gjithsejit 8) e të anketuarëve nuk janë deklaruar në lidhje me këte pyetje.

Për punimi i të dhënave të ndërlidhura me problemet e mjedisit jetësor

Numri i përgjithshëm i përgjegjeve të shënuara për çdo tip të problemit në veçanti në fletën e anketimit , qe identifikuar dhe po i njëjti është paraqitur në **Tabelën 1 (rrradhitja e**

problemeve në tabelë është identike me ato të fletës anketuese të distribuuar më parë)

Tabela 1 – Numri i përgjithshëm i përgjegjeve të shënura për secilin problem në veçanti – sipas vendbanimeve dhe numri i përgjithshëm në nivel të komunës .

Nr. Ren.	PROBLEMI	Mogorçë	Kosovrasti i P.	Kosovrasti i E.	Zepishtë	Otishan	Rajçicë	Banjsht	Në përgjithësi për vendb. rurale	Qyteti i Dibrës	Komuna e Dibrës
1	Grumbullim i paorganizuar i mbeturinave në 12 vendbanime dhe paraqitja e deponive të egra rreth tyre (4)	58	23	19	16	13	3	8	140	388	528
2	Nuk egjstion deponi qëndrore sanitare i cila i kënaqë standardet e përshkruara ligjore (8)	52	15	14	10	9	5	3	108	327	435
3	Deponi e papërshtatshme për grumbullimin e mbeturinave inerte (18)	23	18	11	18	17	4	2	93	211	304
4	Mungesë e një programe të vazhdueshme për informimin dhe ngritjen e vetëdijes publike të qytetarëve (10)	41	23	23	12	5	3	2	109	297	406
5	Mekanizime të vjetërsuara dhe jo të përshtatshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave dhe numër i pamjaftueshëm i kontejnerëve dhe enëve për grumbullimin e mbeturinave (6)	29	28	21	23	11	4	3	119	322	441
6	Nuk egziston plan dhe programë për menaxhim me mbeturinat (9)	34	14	10	13	9	6	5	91	319	410
7	Nuk egziston sistem i organizuar për selektim ,ripërdorim dhe përpunim të mbeturinave të grumbulluara (5)	47	26	20	31	22	4	6	156	330	486
8	Trajtim i papërshtatshëm i mbeturinave me origjinë shtazore. (24)	35	12	3	9	5	2	5	71	173	244
9	7 deponi të egra të regjistruara në periferi të qytetit të Dibrës (19)	15	14	11	8	2	3	1	54	245	299
10	Sisteme kanalizimi të pandërtuara dhe pjesërisht të ndërtuara në 7 vendbanime (13)	33	11	8	13	4	1	3	73	250	323
11	Ndotje e ujrave sipërfaqësor dhe nëntokësor si rezultat i derdhjes direkte të ujrave të ndotur komunal në recipientët (15)	20	20	10	13	11	2	4	80	235	315
12	Mungesë e ujit për pije në qytetin e Dibrës nga vjetërsimi-amortizimi i rrjetit,humbjeve të ujit dhe lidhjeve pa leje (2)	33	29	27	18	15	8	4	134	405	539

13	Efikasitet i dobët i NPK gjatë menaxhimit me sistemet për furnizim me ujë (shkalla e ulët e pagesës, politikë e dobët jopërkatese tarifore për mbulimin e harxhimeve për mirëmbajtje (23)	16	12	15	7	8	5	1	64	202	266
14	Menaxhim jopërkates me sistemet ujësjellëse nga ana e bashkësive lokale në 12 vendbanime (19)	42	11	10	7	11	2	3	86	213	299
15	Bregu i liqenit nuk ka infrastrukturë përkatese (për grumbullim dhe trajtim të ujrave të zeza) për mbrojtjen e Liqenit të Dibrës nga ndotja (1)	26	39	27	35	23	8	6	164	438	602
16	Kanalizime të papërfundura për të rreshurat atmosferike në 60% të teritorit të komunës të Dibrës (12)	21	17	10	20	8	5	2	83	254	337
17	Mungesë e planit dhe programës për zvogëlimin e ndotjes të ajrit dhe avancimin e kualitetit të ajrit ambiental në nivel lokal (13)	21	15	15	17	20	4	2	94	229	323
18	Nuk egziston zgjidhje përkatese e komunikacionit për preorientim të komunikacionit tranzit nga pjesa qendrore e qytetit (26)	12	16	10	14	14	4	1	71	146	217
19	Në komunë nuk ndiqen emisionet të materieve ndotëse në ajr (nuk egzistojnë stacione monitoruese për kualitetin e ajrit) (16)	13	21	12	8	8	2	1	65	244	309
20	Nuk egziston bazë e të dhënave për përdorimin e preparateve agro-kimike në bujqësi dhe ndikimi i tyre në kualitetin e dheut. (28)	8	8	9	3	2	1	2	33	127	160
21	Degradimi i tokës (2 Hektar) si rezultat i gërmimit pa leje të rrerës (30)	8	2	8	3	4	4	1	30	99	129
22	Paraqitja e erozionit në sipërfaqe prej 2 Hek. në Kosovrastin të P. (29)	12	3	4	4	4	6	2	35	104	139
23	Zënje e pakontroluar e tokës(ndërtime pa leje) si rezultat i planifikimit urban jopërkates (21)	35	18	11	11	9	2	0	86	195	281
24	Shfrytëzim i pamjaftueshëm i tokës bujqësore për zhvillimin e prodhimit organik (27)	7	12	10	6	4	1	3	43	172	215
25	Shfrytëzim joracional i ujit, si rezultat i sistemit jofunksional për vaditje (17)	13	14	14	10	9	3	4	67	241	308
26	Prerje dhe shkatërim ilegal i pyjeve (3)	47	27	23	23	23	6	8	157	379	536
27	Rrezikim i egërsirave të rralla (drerit ,shqiponjës,ariut) si rezultat i paraqitjes të gjuajtjes jashtëligjore nëpër viset e gjahut. (25)	23	13	10	8	7	3	4	68	156	224

28	Shfrytëzim i pamjaftueshëm i resurseve natyrore për zhvillimin e ekoturizmit (22)	24	16	15	11	7	3	7	83	187	270
29	Infrastrukturë e pazhvilluar në bregun e liqenit të Dibrës dhe lokacioneve eskursioniste (11)	9	23	16	23	25	7	4	107	239	346
30	Rrezikim i troftës të Radikës dhe llojeve të tjera të peshqive si rezultat i i gjuajtjes ilegale të peshkut (7)	23	30	24	26	21	9	3	136	303	439

Më lartë në **Tabelën 1** është paraqitur rezultati i përgjithshëm për çdo problem të veçantë me mjedisin jetësor, i dhëtur sipas vendbanimeve, si dhe në përgjithësi në nivel të komunës të Dibrës. Rezultati përmbledhës në kolonën e skajshme në të djathtë e paraqet numrin e përgjithshëm e votave të fituara për çdo problem të veçantë me mjedisin jetësor në komunën e Dibrës, ashtu që pikërisht ai rezultat e përcakton prioritetin e problemit. Krahas çdo problemi me mjedisin jetësor, me të kuqe është shënuar numri, që përgjigjet në prioritetin për zgjidhjen e problemit.


Analizë e të dhanave sipas grupeve të vendbanimeve, për çdo lloj të veçantë të problemit


Në vazhdim, do të jepem paraqitje grafike për rezultatin e përgjithshëm të votave të grumbulluara për çdo problem në veçanti i shënuar në fletët anketuese, sipas grupeve të vendbanimeve.

Në Komunën e Dibrës, nga vendbanimet në të cilat u zbatua anketimi publik, mundet të veçohen disa grupe të vendbanimeve në përputhshmëri me numrin e banorëve, edhe ato: **(a)** vendbanime me **mbi 10,000 banorë**: qytetin i Dibrës me gjithsej 14,561 banorë: **(b)** vendbanime me **1,000-5,000 banorë**: f. Mogorçë me 1.794 banorë: **(c)** vendbanime **500- 1,000 banorë**: fshatrat Kosovrasti i Epërm dhe i Poshtëm me 813, gjegjësisht 818 banorë, dhe f. Otishan me 530 banorë: **(d)** vendbanime me **0-500 banorë** f. Zepishtë – 499, f. Rajçicë 131 dhe f. Banjisht – 90 banorë.

Gjithashtu, në formë të grafikoni, do të paraqiten 10 probleme nga lista e prioriteteve, të cilat në përputhje me bindjen e të anketuarve paraqesin prioritetin më të madh për zgjidhjen me mjedisin jetësor. Edhe ato janë të paraqitura në mënzrë përkatse për çdo grup të vendeve të banuara në veçanti.


Për tu vërrejtur më lehtë prioriteti i problemit do të na shërbejë edhe legjenda e dhëtur më poshtë.






Në grafikun jështë paraqitur rezultati përgjithshëm i votave të grumbulluara për çdo problem në veçanti i shënuar në fletën anketuese, për qytetin e Dibrës . Legjenda e cila gjindet menjëherë nën grafikun e paraqet numrin rendor të problemit i shënuar në fletën anketuese (shiko SHTOJCËN

- 10 problemet më prioritare me mjedisin jetësor ,në përputhje me mendimet e banorëve të qytetit të Dibrës




Në përputhje me paraqitjen grafike , nga dhjetë problemet më prioritare për zgjidhje me mjedisin jetësor në qytetin e Dibrës . problemi nën numrin rendor 15 nga fleta anketuese (shiqo SHTOJCËN 1) paraqet problem më me prioritet ,numër një për tu zgjidhur, dhe po i njeiti është shënuar nga 438 të anketuar , 405 të anketuar janë përcaktuar për problemin me numër rendor 12 , ashtu që ai identifikohet si prioritet i dytë.Menjëherë pas tij me shkallë të prioritetit – 3 , është shënuar problemi me numër rendor – 1 nga fleta anketuese , për të cilin janë përcaktuar 388 të anketuar .Më pak vota të fituara ka problemi me numër rendor 4 nga fleta anketuese , ashtu që i njeiti identifikohet si problem me prioritetvmë të vogël për zgjidhje (shkalla e prioritetit – 10). Problemi i dytë me prioritet më të vogël që kërkon zgjidhje (shkalla e prioritetit – 9) është problemi i identifikuar nën numrin rendor 30 në fletën anketuese , me numër të përgjithshëm të votave të fituara – 303.

b) Rezultati i përgjithshëm nga votat e fitura për llojin e problemit për grupe venbanimesh me 1,000- 5,000 banorë



Në grafik është paraqitur rezultati i përgjithshëm nga votat e grumbulluara për çdo problem në veçanti i shënuar në fletët anketuese , për vendbanim me 1,000 – 5,000 banorë , përkatësisht , f. Mogorçë. Legjenda e cila gjindet menjëherë nën grafikun e paraqet numrin rendor të problemit me të cilin është shënuar në fletën anketuese (shiqo SHTOJCËN 1)


- 10 problemet më prioritare me mjedisin jetësor ,në përputhje me mendimet e banorëve të vendbanimit të quajtur Mogorçë -



Në përputhje me paraqitjen grafike nga djetë problemet prioritare me mjedisim jetësor për tu zgjidhur në fshatin Mogorçë , problem me priuoritet numër një për tu zgjidhur është problemi me numrin rendor 1 nga fleta anketuese


(shiqo SHTOJCËN 1) dhe dhe njejt qe shënuar nga 58 të anketuar. Kurse 52 të anketuar u përcaktuan për problemin me numër rendor 2 në fletën anketuese, ashtu që ai është identifikuar si prioritet i dytë. Dy herë për dy probleme të ndryshme nga lista , u përcaktuan numër i njejtë i të anketuarve . Ata janë problemet nën numrin rendor 8 dhe 23 nga fleta anketuese , me shkallë të prioritetit – 7 për zgjidhjen e tyre, përkatësisht problemet nën numrin 10 dhe 12 nga fleta e anketimit , me shkallëtë prioritetit - 9 . Në këte grup prej 10 problemeve më prioritare për tu zgjidhur , më pak vota të fituara ka problemi nën numrin rendor 5 nga fleta anketuese , ashtu që po i njejt identifikohet si problem me prioritet më të vogël për tu zgjidhur (shkalla e prioritetit – 10). Për ate problem qenë përcaktuar 29 të anketuar nga numri i përgjithshëm i të anketuarve që u përfshinë në anketimin publik.

c) Rezultati i përgjithshëm nga votat e grumbulluara sipas llojit të problemit për grupe vendbanimesh me 500 – 1000 banorë




Në grafik është paraqitur rezultati i përgjithshëm nga votat e grumbulluara për çdo problem në veçanti i shënuar në fletët anketuese , për vendbanim me 500 – 1,000 banorë , përkatësisht , f. Kosovrasti i Epërm dhe i Poshtëmme f. Otishan. Legjenda e cila gjindet menjëherë nën grafikun e paraqet numrin rendor të problemit me të cilin është shënuar në fletën anketuese (shiqo SHTOJCËN 1)

- 10 problemet më prioritare me mjedisin jetësor ,në përputhje me mendimet e banorëve të vendbanimeve Kosovrasti i Epërm dhe i Poshtëm dhe f. Otishan -




Në përputhje me grafikun e paraqitur nga dhjetë problemet më prioritare me mjedisin jetësor për ti zgjidhur në vendbanimet me 500 – 1,000 banorë , përkatësisht , fshatrat , përkatësisht , f. Kosovrasti i Epërm S dhe i Poshtëm me f. Otishan , problemi nën rendin numëror 15 nga fleta anketuese o(shiqo SHTOJCËN 1) paraqet problem me prioritet numër një për tu zgjidhur dhe i njëjti është i shënuar nga 89 të anketuar .Ndërsa 75 të anketuar janë përcaktuar për problemin nën numër rendor 30, ashtu që ai identifikohet si problem i dytë për kah prioriteti. Menjëherë pas tij me shkallë prioriteti – 3, shënohet problemi me numër rendor 26 nga fleta e anketimit , për të cilin janë përcaktuar 73 të anketuar. Më pak vota të fituara ka problemi me numër rendor 17 në fletën e anketimit , ashtu që i njëjti identifikohet me shkallë më të ulët të prioritetit për tu zgjidhur (shkalla e prioritetit – 10). Problemi i dytë me prioritet më të vogël për tu zgjidhur (shkalla e prioritetit – 9), është problemi i identifikuar me numrin rendor 4 në fletën e anketimit me numër të përgjithshëm të votave të fituara – 51 dhe ashtu me rradhë...

d) Rezultati i përgjithshëm i votave të grumbulluara sipas llojit të problemit për grupin vendbanimeve prej 0 - 500 banorë



Në grafik është paraqitur rezultati i përgjithshëm nga votat e grumbulluara për çdo problem në veçanti i shënuar në fletët anketuese , për vendbanim me 500 – 1,000 banorë , përkatësisht , f. Kosovrasti i Epërm dhe i Poshtëmme f. Otishan. Legjenda e cila gjindet menjëherë nën grafikun e paraqet numrin rendor të problemit me të cilin është shënuar në fletën anketuese (shiqo SHTOJCËN 1)

- 10 probleme më prioritare me mjedisin jetësor , në përputhje me mendimin e popullatës të vendbanimeve Zepishtë, Rajçicë dhe Banjisht -



Në përputhje me pasqyrën grafike të paraqitur , nga dhjetë problemet më prioritare me mjedisin jetësor për tu zgjidhur në fshatrat Zepishtë,Rajçicë dhe Banjisht, problem me prioritet numër një për tu zgjidhur është problemi me numër rendor 15 në fletën e anketimit (shiqo SHTOJCËN 1) dhe i njeiti qe shënuar nga ana e 49 të anketuarve.Kurse 41 të anketuar u deklaruan për problemin numër 7 , ashtu që ai është identifikuar si prioritet i dytë. Në tri raste për dy probleme të ndryshëm nga lista , u deklaruan numër i njejtë i të anketuarëve.Ata janë problemet nën numrin 5 dhe 12 nga fleta anketuese, me shkallë të prioritetit – 6 për zgjidhjen e tyre, problemet 1 dhe 16 , me shkallë të prioritetit – 7, përkatësisht problemet nën numrin rendor 3 dhe 6 nga fleta anketuese , me shkallë të prioritetit – 8, Në këtë grup prej 10 problemeve më prioritare për tu zgjidhur, më pak vota të fituara ka problemi me numër rendor 28 në fletën anketuese , ashtu që i njeiti identifikohet si problem me prioritet më të vogël për tu zgjidhur (shkalla prioritare – 10).Për këtë problem u deklaruan 21 të anketuar nga numri i përgjithshëm i të anketuarve që morrën pjesë në anketimin publik.

Në përpjekje për tu bërë krahasim në mënyrën e mendimit të banorëve nga vendbanimet më të mëdhaja (urbane) – mbi 10,000 banorë dhe banorëve të lagjeve më të vogla – deri 5,000 banorë, që përpunuar analizë për rezultatin përfundimtar (numër i përgjithshëm i votave të grumbulluara) sipas tipit të problemit, për grupe vendbanimesh.

Në grupin e parë me mbi 10,000 banorë numerote vendbanimi – Qyteti i Dibrës. Nga paraqitja grafike e dhënë për këtë vendbanim – **(a) Rezultati i përgjithshëm i votave të grumbulluara sipas llojit të problemit për qytetin e Dibrës (vendbanim me mbi 10,000 banorë)**, në grupën e 10 problemeve prioritare për tu zgjidhur , të cilat qenë shënuar nga ana e qytetarëve të këtij qyteti, janë problemet me numër rendor: 1, 2, 4, 5, 6, 7, 12, 15, 26 dhe 30 në fletën anketuese. Të njëjtët janë dhënë më poshtë në listën, duke filluar nga problema më i shënuar deri te ai që është shënuar më pak, përkatësisht:

- Bregu i liqenit nuk ka infrastrukturë përkatëse (për grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të zeza) për mbrojtjen e liqenit të Dibrës nga ndotja,
- Mungesë e ujit për pije në qytetin e Dibrës nga vjetërsimi i rrjetit, humbjet e ujit për pije dhe kyçjet pa leje në rrjet.
- Grumbullimi paorganizuar i mbeturinave në 12 vendbanime dhe paraqitja e deponive të egrra në rrethinën e tyre.
- Prerrje dhe shkatërim jolegal i pyjeve.
- Nuk egziston sistem i organizuar për selektim, ripërdorim të mbeturinave të grumbulluara.
- Nuk egziston deponi qendrore sanitare e cila i përmbush standardet e parapara ligjore.
- Maqineri të vjetërsuara dhe jopërkatëse për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave dhe numër i pamjaftueshëm i kontejnerëve dhe enëve për grumbullimin e mbeturinave.
- Nuk egziston plan dhe programë për menaxhim me mbeturinat,
- Rrezikimi i troftës të Radikës dhe llojeve të tjera të peshqive si rezultat i i gjuajtjen në mënyrë jolegale.
- Mungesë e programës të vazhdueshme për informim dhe ngritjen e vetëdijes publike të qytetarëve.

Në vazhdim , në **Tabelën 2** është paraqitur rezultati i përgjithshëm i votave të grumbulluara për ato probleme nga fleta anketuese, të cilat në përputhje me shkallën e rruajtjes të qytetarëve të anketuar nga gjithë vendbanimet e tjera të mbetura në komunën e Dibrës, me përjashtim të qytetit të Dibrës, gjenden në grupin e problemeve prioritare (10 të parët) për tu zgjidhur.

Tabela 2 – Numri i përgjithshëm i përgjegjeve të shënuara për problemet prioritare, në përputhje me mendimin e qytetarëve në gjithë vendet e banuara në komunën e Dibrës, me përjashtim të qytetit të Dibrës.

Vendbanim	nga 1,000 - 5,000 banorë										nga 500 - 1,000 banorë										nga 0 - 500 banorë																													
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30																				
	58	52	41	34	47	35	33	33	42												35	47									55	51	60	68														73	64	75
	27	24	30	24	41																30	49	27	23							37	21	34	38																
TAL	140	52	24	92	90	58	156	35	33	134	42	138	27	73							35	157	21	98	113																									

10-të problemet më shpesh të shënuara nga ana e banorëve për gjithë vendbanimet e tjera në komunë(pa qytetin e Dibrës), janë problemet e shënuara me numrat rendor në fletët anketuese edhe ato 1, 4, 5, 7, 12, 15, 17, 26, 29, dhe 30. Të njëjtat janë të dhanura në listën e mëposhtme , duke filluar prej më shpesh të shënuarit deri te më pak të shënuarit, përkatësisht:

- Prerja dhe shkatërimi jolegal i pyjeve
- Nuk egziston sistem i organizuar për selektim, ripërdorim të mbeturinave të grumbulluara.
- Grumbullim i paorganizuar i mbeturinave në 12 vendbanime dhe paraqitja e deponive të egra në rrethinën e tyre.
- Bregu i liqenit nuk ka infrastrukturë përkatëse (për grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të zeza) për mbrojtjen e liqenit të Dibrës nga ndotja,
- Mungesë e ujit për pije në qytetin e Dibrës nga vjetërsimi i rrjetit, humbjet e ujit për pije dhe kyçjet pa leje në rrjet.
- Rrezikimi i troftës të Radikës dhe llojeve të tjera të peshqive si rezultat i i gjuajtjen në mënyrë jolegale.
- Infrastrukturë e pazhvilluar në bregun e liqenit të Dibrës dhe lokacione eskursioniste
- Mungesë e programës të vazhdueshme për informim dhe ngritjen e vetëdijes publike të qytetarëve.
- Maqineri të vjetërsuara dhe jopërkatëse për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave dhe numër i pamjaftueshëm i kontejnerëve dhe enëve për grumbullimin e mbeturinave.
- Mungesë e planit dhe programës për zvogëlimin e ndotjes të ajrit dhe avancimin e ajrit kualitativ ambiental në nivel lokal

